

# **PERMBLEDHJE JO TEKNIK E RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS**

**Zhvilluesi: Shoqeria “M.C. ENERGJI GOJAN” Sh.p.k.**

**Investitori: Shoqeria “M.C. ENERGJI GOJAN” Sh.p.k.**

**Objekti: NDËRTIM I HEC GOJAN**

**Vendndodhja: Lumi Fan i Madh, zona midis fshtarave Shkozë dhe Gojan,  
Njësia Administrative Gjegjan, Bashkia Pukë, Qarku  
Shkodër**

Tiranë, Tetor 2019

## **TE DHENAT KRYESORE TE PROJEKTIT**

**Propozuesi: "M.C. ENERGJI GOJAN" Sh.p.k.**

**Emertimi: NDERTIM HEC GOJAN**

**Fuqia e instaluar:**  $N = 15000 \text{ kW}$

**Energjia e prodhuar:**  $E = 47,800,000 \text{ kWh/vit}$

**Prurja mesatare:**  $Q_{\text{mes}} = 8.32 \text{ m}^3/\text{sek}$

**Prurja llogariteze:**  $Q_{\text{llo}} = 16 \text{ m}^3/\text{s}$

**Prurja ekologjike:**  $Q_{\text{ekol}} = 0.53 \text{ m}^3/\text{s}$

**Prurja per bujqesine (ujitje):**  $Q_{\text{bujq}} = 0.15 \text{ m}^3/\text{s}$

**Pozicioni i zgjedhur:** Lumi Fan i Madh, zona midis fshtarave  
Shkozë dhe Gojan, Njësia Administrative  
Gjegjan, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër

**Baza ligjore:** Neni 8, pika b) e Ligjit Nr.10440, date 07.07.2011  
“Për VNM”

**Shtojca 2, Pika 3, ë): Instalime per prodhimi e energjise  
hidroelektrike**

## I. PERSHKRIM I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

### 1.1. Vleresim i pergjithshem

Rrethi i Pukës shtrihet në pjesën qëndrore të Shqipërisë Veriore (në hartën botërore shtrihet  $42^{\circ}2'39''$  në veri të ekuadorit dhe  $19^{\circ}53'58''$  në lindje të meridianit të parë). Puka shtrihet përgjatë krahut të majtë të lumbit Drin, që nga Ura e Vezirit e Fusha e Dukagjinit në lindje dhe deri në afërsi të grykëderdhjes së lumbit Gomsiqe në perëndim. Nga jugu, Puka kufizohet me Mirditën në kreshtat malore të Majës së Runës, Thirrës, Majës së Roshit, dhe Bjeshkëve të Tërbunit. Rrethi i Pukës ka një sipërfaqe prej  $1033,69 \text{ km}^2$ .

Bimësia në Malësinë e Pukës është e pasur dhe e larmishme. Në të rriten rreth 160 lloje drurësh. Më të përhapurit janë: pisha e zezë, bredhi i bardhë, ahu, lisi, shkoza, etj. Bimësia pyjore mbulon rreth 80% të shpërfaqjes së rrethit duke e bërë atë një nga zonat më të pasuara në Shqipëri. Pylli ka qenë e mbetet simbol për Pukën. Gjithashtu, në pyjet e Pukës strehohet një faunë e pasur ku ndeshen ujku, dhelpra, lepuri, vjedulla, derri i egër, dhia e egër, ariu si dhe shpendë të tilla si thëllëza, pëllumbi i egër, gjeli i egër, etj.

Klima është me dimra të ftohtë dhe reshje të shumta (rreth 2020 mm në vit). Temperatura mesatare e të ftohtit është  $-3^{\circ}\text{C}$  dhe e ulëta arrin deri në  $-24^{\circ}\text{C}$ . Mesatarja e të nxehtit në verë arrin në  $+20^{\circ}\text{C}$ . Më e larta arrin deri në  $+39^{\circ}\text{C}$ . Në shumë zona, bora zgjat deri në prill.

Në Pukë ndodhen shumë monumente të natyrës si Akaciet e Migjenit, Pisha e Dardhës, Guri i Shenjtë, Gështenjat e Kokëdodës, Sofra e Lekës, Shpella e Kaurrit, Ujëvara e Kryeziut, etj. Në Shtojcën 1 është paraqitur lista e monumenteve të natyrës.

Shqipëria për vetë pozicionin gjeografik në të cilin ndodhet, si dhe kushtet e favorshme fiziko-gjeografike (ndërtimi gjeologjik, larmia e formave të reliefit, klima e larmishme, rrjeti i pasur hidrografik, llojet e tokave si dhe natyra edafike e shumëlojshme) renditet ndër vendet e para europiane për pasuritë floristike. Në Shqipëri rriten rreth 47% e llojeve të bimëve të Ballkanit dhe 30% e llojeve të bimëve të Europës<sup>3</sup>. Flora e Shqipërisë përfshin rreth 3 250 specie të ndryshme bimore të cilat u përkasin 165 familjeve dhe 910 gjinive. Rreth 1.1% ose 28 specie dhe 150 subspecie janë endemike. Rreth 300 specie janë bimë mjekësore dhe aromatike dhe rreth 10 % të florës së Shqipërisë e zënë speciet e rralla, speciet në rrezik zhdukje dhe llojet relikte<sup>4</sup>. Origjina e bimësise së Shqipërisë është nga vende të ndryshme, por përhapja ka më shumë lidhje me viset veriore sesa ato jugore, kjo gjë dëshmohet dhe nga fakti se rreth 25% e tyre kanë origjinë mesdhetare, 22% origjinë

## II. PERSHKRIM I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOZOHET TE ZBATOHET PROJEKTI

### 2.1 Vleresim i pergjithshem

Rrethi i Pukës shtrihet në pjesën qëndrore të Shqipërisë Veriore (në hartën botërore shtrihet  $42^{\circ}2'39''$  në veri të ekuadorit dhe  $19^{\circ}53'58''$  në lindje të meridianit të parë). Puka shtrihet përgjatë krahut të majtë të lumit Drin, që nga Ura e Vezirit e Fusha e Dukagjinit në lindje dhe deri në afersi të grykëderdhjes së lumit Gomsiqe në perëndim. Nga jugu, Puka kufizohet me Mirditën në kreshtat malore të Majës së Runës, Thirrës, Majës së Roshit, dhe Bjeshkëve të Tërbunit. Rrethi i Pukës ka një sipërfaqe prej  $1033,69 \text{ km}^2$ .

Bimësia në Malësinë e Pukës është e pasur dhe e larmishme. Në të rriten rreth 160 lloje drurësh. Më të përhapurit janë: pisha e zezë, bredhi i bardhë, ahu, lisi, shkoza, etj. Bimësia pyjore mbulon rreth 80% të shpërfaqjes së rrethit duke e bërë atë një nga zonat më të pasuara në Shqipëri. Pylli ka qenë e mbetet simbol për Pukën. Gjithashtu, në pyjet e Pukës strehohet një faunë e pasur ku ndeshen ujku, dhelpra, lepuri, vjedulla, derri i egër, dhia e egër, ariu si dhe shpendë të tillë si thëllëza, pëllumbi i egër, gjeli i egër, etj.

Klima është me dimra të ftohtë dhe reshje të shumta (rreth 2020 mm në vit). Temperatura mesatare e të ftohitit është  $-3^{\circ}\text{C}$  dhe e ulëta arrin deri në  $-24^{\circ}\text{C}$ . Mesatarja e të nxehtit në verë arrin në  $+20^{\circ}\text{C}$ . Më e larta arrin deri në  $+39^{\circ}\text{C}$ . Në shumë zona, bora zgjat deri në prill.

Në Pukë ndodhen shumë monumente të natyrës si Akaciet e Migjenit, Pisha e Dardhës, Guri i Shenjtë, Gështenjat e Kokëdodës, Sofra e Lekës, Shpella e Kaurrit, Ujëvara e Kryeziut, etj. Në Shtojcën 1 është paraqitur lista e monumenteve të natyrës.

Shqipëria për vetë pozicionin gjeografik në të cilin ndodhet, si dhe kushtet e favorshme fiziko-gjeografike (ndërtimi gjeologjik, larmia e formave të reliefit, klima e larmishme, rrjeti i pasur hidrografik, llojet e tokave si dhe natyra edafike e shumëllojshme) renditet ndër vendet e para europiane për pasuritë floristike. Në Shqipëri rriten rreth 47% e llojeve të bimëve të Ballkanit dhe 30% e llojeve të bimëve të Europës<sup>3</sup>. Flora e Shqipërisë përfshin rreth 3 250 specie të ndryshme bimore të cilat u përkasin 165 familjeve dhe 910 gjinive. Rreth 1.1% ose 28 specie dhe 150 subspesie janë endemike. Rreth 300 specie janë bimë mjekësore dhe aromatike dhe rrëth 10 % të florës së Shqipërisë e zënë speciet e rralla, speciet në rrezik zhdukje dhe llojet relikt<sup>4</sup>. Origjina e bimësisë së Shqipërisë është nga vende të ndryshme, por përhapja ka më shumë lidhje me viset veriore sesa ato jugore, kjo gjë dëshmohet dhe nga fakti se rrëth 25% e tyre kanë origjinë mesdhetare, 22% origjinë

ballkanike, 18% origjinë evropiane, 14% origjinë euro-aziatike, 5.5% e bimëve janë të kultivuara, 4.5% janë kosmopolite, 4% euro-siberiane dhe 8% të tjera.

Flora e Shqipërisë përbën një potencial të konsiderueshmët të biodiversitetit me vlera ekologjike, ekonomike, estetike dhe etike. Vlerat e tyre ekologjike qëndrojnë në ndërvarësinë e llojeve nga njëri-tjetri ku zhdukja e një lloji shoqërohet edhe me zhdukjen e një ose disa llojeve të tjera. Ndërsa vlerat e tyre ekonomike janë të konsiderueshme po të kemi parasysh përdorimin e tyre për dru zjarri, lëndë të parë për ndërtim ose mobilie, përdorimin e tyre për ushqim, si dhe vlerat farmaceutike dhe aromatike që kanë bimët mjekësore dhe aromatike.

## 2.2. Bashkia Puke, Pozicioni gjeografik

Bashkia e Pukës është një njësi administrative me shtrirje të gjerë territoriale në pjesën verilindore të territorit të Republikës së Shqipërisë, ku kufizohet me Bashkinë Mirditë, Vau i Dejës, Fushë-Arrëz dhe Lezhë. Kjo bashki shtrihet kryesisht në terren


malor në lartësi rrëth 780-850 m mbi nivelin e detit.

Në kuadër të reformës së re territoriale, Bashkia Pukë aktualisht përbëhet nga nga 5 NJA (Njësi Administrative), të cilat janë: Pukë, Rrapë, Qelëz, Gjegjan dhe Qerret, ku qendra e bashkisë është qyteti i Pukës.

Bashkia e madhe ka një popullsi afersisht **16 720 banorë** (sipas të dhënave të gjendjes civile) dhe **12 976 banorë** (sipas vlerës të grantit të llogaritur nga Ministria e Financës).

Numri i familjeve raportohet të jetë **3,454**. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej  $950 \text{ km}^2$ , dhe në total në të gjithë territorin e bashkisë operojnë 180 biznese të vogla, 18 të mëdha dhe 33 institucionë.

Sektori i industrisë është më pak i zhvilluar në Pukë. Mungesa e përvojës, e bashkëpunimit dhe e infrastrukturës e bëjnë agroindustrinë degën më të dobët në rajon. Vendet e punës në këtë sektor kanë lidhje kryesisht me prodhimin e energjisë elektrike dhe ndërtimin.



### 2.3. Mbulesa bimore

Ka një lidhje të ngushtë midis kushteve klimatike të vendit tonë me mbulesën e tokave, e cila përfaqësohet nga tokat e hirta kafe në lartësinë deri 600 m, tokat e kafenjta malore deri në lartësinë 600-1000 m mbi nivelin e detit, tokat e murme pyjore në lartësinë 1200-1800 m dhe tokat livadhere malore në 1800-2700 m. Lloji më i përhapur i tokave janë tokat e murme pyjore me 38,3% të sipërfaqesë përgjithshme.

Kushtet edafike dhe klimatike të Shqipërisë përcaktojnë një zonalitet vertikal të shprehur në një mbulesë bimore të pasur dhe të shumëllojshme (3,220 lloje e cila pëbën 29% të llojeve të Evropës dhe 47% të florës së gadishullit të Ballkanit. 1% janë bimësi endemike., ndërsa 5% subendemike) të përbërë nga katë bimore: kat i shkurretave mesdhetare që shkon deri 800 m mbi nivelin e detit(ky kat njihet ndryshe edhe si zona makje-shibljak), kat i i dushkut që shkon nga 400 deri 1200 m mbi nivelin e detit, kat i ahut që shkon nga 800 deri 2000 m mbi nivelin e detit, dhe kat i kullotave alpinë që shkon nga 1800 deri 2700 m mbi nivelin e detit. Në këta breza bimorë takohet një faunë mjaft e pasur gjitarësh, shpezësh dhe zvaranikësh.

Mbulesa bimore ka një ndikim të madh mbi erozionin e cila e shpreh ndikimin e saj qoftë sipas llojit të bimësisë ashtu edhe në bazë të përqindjes së mbulesës bimore.

### HARTË E SHPËRNDARJES BIMORE

Katë Bimore




Fig – Harta e shpërndarjes bimore, Rajoni i Veriut

Që nga viti 2000, Shqipëria ka bërë përparim në mbrojtjen e biodiversitetit, të të gjitha ekosistemeve dhe specieve biologjike të gjetura në zonë, përmes zhvillimit dhe zbatimit të një kuadri institucional dhe legjislativ.

Bashkia Pukë, e cila ka një sipërfaqe mjaft të gjërë pyjore, me florë dhe faunë të pasur. Bimësia pyjore në malet e Bashkisë është e pasur dhe e larmishme me rreth 160 specie me pemë; ku më të përhapurat janë shkurret Mesdhetare, dushk, ah, pisha e zeza, bredhi i bardhë, shkoza, etj.

Përsa i përket florës, janë bërë përpjekje për të listuar bimët mjekësore të Bashkisë që nga viti 1980, atëherë u regjistruan në nivel vendi 19 lloje. Më vonë, në vitin 1988, u bë regjistrimi i bimeve mjekësore nga një grup pune i specialitetave të ndryshme. Nga ky studim janë identifikuar 210 lloje bimësh në të gjithë vendin, nga të cilat 17 lloje janë identifikuar në nivel rajonal dhe janë si në vijim: bliri, arra, boronica, gështena, akacia, dellinja e kuqe, shqema, lajithia, shtogu, murrizi, lisra, melisa, rigoni, hithra, lulebalsami (lulegjaku), mullaga dhe trumeza.

Sa i përket hulumtimit gjeo-botanik të bimëve që mbulojnë Bashkinë (përgatitur në vitin 2002), janë regjistruar 187 lloje bimësh medicinale dhe aromatike. Sasia dhe natyra e tyre është një proces dinamik që pëson ndryshime gjatë viteve nga shkaqe të ndryshme, si djegia, prerja e vegjetacionit, tharja e sipërfaqes së tokës, erozioni i tokës, kullotja etj. Pra, është i nevojshëm që inventari i territorit të bëhet çdo tetë deri në dhjetë vjet. Në zonën e studimit, vlen të përmendet eko-sistemi i tokës bujqësore (Ekosistemi i tokave të kultivuara bujqësore), i cili është veçanërisht i pasur. Takohen përafërsisht 60 bimë medicinale dhe fruta pyjore. Ky ekosistem është i vendosur kryesisht pranë rrjedhave. Gjenden zakonisht manaferra (*Rubus fruticosa*), thana (*Cornus mas*), geshtena (*Castanea sativa*), arra (*Juglans regia*), karraota e eger (*D. carraota*), shelgjet (*Salix spp*), cikoria (*C. intybus*), shtogu (*Sabucus nigra*), bari i blethes (*Melissa officinalis*), menta (*Metha spp*).




Figura.... Arra Juhlan/R regia (Burimi: Gjendja e bimeve mjeksore -terifere dhe frutave te pyllit ne territorin e Bashkise Puke



Figura.... Dellinja e kuqe/ Juniperus oxycedrus(Burimi: Gjendja e bimeve mjeksore -terifere dhe frutave te pyllit ne territorin e Bashkise Puke



Figura.... Lule gjaku/ *Hypericum perforatum* (Burimi:  
Gjendja e bimeve mjeksore -terifere dhe frutave te pyllit  
ne territorin e Bashkise Puke



Figura.... Bari i Bletes/*Melisa officinalis* (Burimi:  
Gjendja e bimeve mjeksore -terifere dhe frutave te pyllit  
ne territorin e Bashkise Puke

Ekosistemet kontinentale në zonën e studimit klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Zona bimore e ahut. Ndodhet në një lartësi prej 900-1700 m dhe speciet e saj janë pisha e zezë, ahu dhe bredhi.
- Zona bimore e dusheve. Ndodhet midis zonës së makjes dhe zonës bimore me çaj, në një lartësi prej 230 deri 900 m mbi nivelin e detit. Është e ndarë në zona të veçanta dhe përfshin zonën e dushqeve (*Q.sessiliflora*, *Quercus sp*), qarrit të bardhë (*Q.cerris L*), frashërit (*F.ornus*), ulzës (*A.tartaricum*), dëllinjës së kuqe (*J.Oxycedrus*), boshrës (*Forsycia europea L*), shqemës dhe cermedellit (*Rus coriaria L* e *R continuus*) etj.
- Zona bimore e makjes. Ka një sipërfaqe të kufizuar dhe përfshin ekosistemin e lisit (Tokat e ekosistemit të maresë - *Arbutum unedum*) dhe ekosistemet e tokës (Tokat e ekosistemit të shqopës - *Erica arborea*). Takohen lloje si e kuqe, frashëri, trumëza, lisra, dhe fishkarta, në tokat kënetore takohen gjithashtu: shega (*Punica granatum*), lisra, trumëza, gjëmbori, rushkulli (*Ruscus aculeatus*), (*F.vulgaris*), rrushqyqja (*Idum acer*), (*Inila viscaria*), mënishtja, (*Citrus villosum*), fishkarta, fiku (*F.carica*) etj.
- Tokat e punuara.

Pyjet e Bashkisë së Pukës kanë një faunë të pasur. Kështu takohen disa lloje kafshesh të egra si: ujku, dhelpra gri dhe e kuqe, lepuri, borxh, derri i egër, mace e egër, ariu i murrmë, dreri, lepuri, iriqi dhe shumë zogj si shqiponja, frëngji, pëllumbat e egër. Në malin e Munellës gjendet më shpesh rrëqebulli (*Lynx*), por gjithashtu

takohen edhe gjitarë të tjera, amfibë dhe zvarranikë. Gjithash tu vlen të përmendet se shpatet e Malit të Munellës janë një nga



zonat e pakta ku riprodhohet urithi.

Figura.... Rriqebulli i Ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*)  
Burimi: Çelsi turistik Puke

Figura.... Kaprolli / *Capreolus capreolus*) Burimi:  
Çelsi turistik Puke




Figura.... Ariu i Murrme (*Ursus arctos*) Burimi: Çelsi  
turistik Puke




Figura.... Macja e eger (*Felis silvestris*) Burimi:  
Çelsi turistik Puke


## 2.5. Flora dhe Fauna ne zonen ku propozohet te zhvillohet projekti



Konfigurimi i mbuleses bimore tek Vepra e Marrjes dhe Dekantuesi (burimi: asig.gov.al)



Konfigurimi i mbuleses bimore tek Ndertesa e HEC, Baseni Presionit dhe Tubacioni Turbinave



Ne rajonizimin fiziko-gjeografik te Shqiperise, zona ku zhvillohet projekt i propozuar i ndertimit te HEC GOJAN, perfshihet ne Krahinen Malore Qendrore. Kjo krahine perfshire zonen tektonike te Korabit, te Mirdites, pjesen me te madhe te zones se Kraste-Cukalit dhe te Krujës.

Per shkak te larmise litolog-strukturore dhe te faktoreve dhe faktoreve te mofrodnimakes se jashtnme te Krahines Malore Qendrore shumellojshmeria e reliefit si dhe na ana morfolojike ashtu dhe morfogenetike eshte me e shprehur se ne krahinat e tjera te vendit.

Klima e kesaj krahine eshte mjaft e larmishme. Ketu jane rregjistruar vlerat me te ulta te oreve me ndicim diellor (ne Kukes mbi 200 ore ne vit), te rrezatimit diellor (ne Kukes 1205 kw/m<sup>2</sup>) si dhe numri me i madh i diteve te vraneta. Dallohet gjithahstu per rastisjen, kohezgjatjen dhe intensitetin me te larte te ererave te vtohta veriore e verilindore, per trashesin dhe numrin me te madhe te diteve me shtrese

debore, te diteve te akullta, si dhe per sasine mesatar vjetore me te vogel te reshjeve. Sipas rajonizimit klimatik kjo krahine permblehd disa zona e nenzona klimatike (zona klimatike mesdhetare, para malore dhe malore), te cilat shoqerohen me ndyshime perkatese ne mbulesen bimore dhe shumellojshmerine e tokave dhe te botes shtazore.

### Malesia e Pukë-Mirditës

Malësia e Pukë-Mirditës shtrihet në pjesën veriore të Krahinës Malore Qendrore, në veri të rrjedhjes së mesme të Gjadrit dhe të vijës morfollogjike Kalivaç-Kaçinar-Shëpal. Në perëndim kjo malësi zbret në Ultësirën e Shkodrës, kurse në lindje përfundon në luginën e Srriqes dhe në atë të Fanit të Vogël. Malësia ka gjatësi e

gjerësi gati të barabartë (45-46 km), një sipërfaqe prej rreth 2000 km<sup>2</sup>, dhe formën e një shumëkëndëshi të rregullt me drejtim të përgjithshëm verilindje-jugperëndim.

Orogjeneza e re plioquaternare, e cila kishte karakter dif'erencues i ka dhënë strukturave të kësaj malësie tipare të reja, bllokore dhe luslore. Të parat shtrihen në brendësi të kësaj zone, kurse të dytë në periferinë veriore dhe veriperëndimore të saj. Këto shprehen mjaft mirë edhe në relief, në ngritjen më të madhe të strukturës së Munellës (rreth 500 m më të lartë se ajo e Tërbun Kuzhnenit dhe 300 m nga ajo e Krab-Kunorë-Dardhës). Vetë lugina e Fanit të Madh, më e madhja e kësaj malësie, është formuar në thyerjen tektonike që ndan strukturat e lartpërmendura.

Në pliocen-kuaternar kjo malësi u ngrit nga lëvizjet e reja tektonik e në formën e një blloku, që u shoqërua me fundosje në skajet e tij. Ngritjet më të mëdha i pësuan mali i Munellës dhe Krab-Kunorë-Dardha. Ngritja e territorit në tërësi ndikoi në fillimin e një faze të re të modelimit të reliefit. (178» Kështu sipërfaqja erozive e formuar në neogen u copëtua dhe u transformua në një relief kodrinor e malor të çrrregullt, me lartësi mesatare, por të ashpër. Ngritjet e reja gjatë kuaternarit i dhanë mundësi rrjetit hidrografik të thellojë luginat dhe të gjallërojë fuqimisht proceset e shpatit.

Pjesa qendrore e malësisë formon një kurri malor kryesor në formën e germës U të përbysur, në veri të së cilës formohen dy shkallë strukturore-erozive, ajo e Iballës dhe Korthpulës. Pjesa e brendshme e kurrit kryesor përshkohet nga Lumi i Zi (degë e djathtë e Fanit të Madh). Ndryshimet e theksuara midis kurrikeve malore dhe gropave përreth në këtë malësi kanë çuar në një zhvillim intensiv të veprimit të ujërave rrjedhëse. Kjo ka bërë që copëtimi horizontal të marrë vlera 3,5-4 km/km<sup>2</sup>, kurse vlerat skajore të lëvizin nga 0,2 deri 9 km/km". Vlerat e larta të copëtimit horizontal shpjegohen me përhapjen e gjerë të shkëmbinjve pak të përshkueshëm (terrigenë, magmatikë) dhe me sasinë e madhe të reshjeve. Pasojë e këtij copëtimi është zhvillimi i shumë sipërfaqeve të degraduara të tillë si në Berishë, Bugjon, Dush, Kimzë etj.

Kjo malësi dallohet edhe për copëtim shumë të madh vertikal të reliefit (deri në 850 m/km<sup>2</sup>), kurse vlera mesatare është rreth 300 m/km<sup>2</sup>. Vlerat më të vogla të këtij copëtimi zakonisht takohen në kurrit e maleve Tërbun, Kuzhnen, Krab-Kunorë-Dardhë e Munellë. Vlerat e larta të copëtimit vertikal lidhen me përbërjen litologjike (kryesisht ultrabajzikë dhe pjesërisht gëlqerorë) dhe me veprimitarinë e fuqishme erozive të rrjetit hidrografik si pasojë e ngritjeve të reja tektonike. Ndërtipat kryesorë të reliefit dallohen reliivi strukturoro-eroziv, denudues, lumor dhe karstik.

Temperaturat mesatare vjetore lëvizin nga 8.8 (Iballë) në 10° (Pukës) dhe rreth 12° në Fierzë dhe Korthpulë. Mesataret e janarit lëvizin nga - 0.2° (Iballë), 0° (Pukë), 1.5° (Fierzë) dhe 3.2° (Korthpulë), kurse ato të korrikut nga 17.5° (Iballë), në 19.8° (Pukë) dhe 21.60 (Fierzë dhe Korthpulë).

Në malësinë e Pukë-Mirditës fryshtë shpesh, erëra të ftohta që shkaktojnë ulje të theksuara të temperaturës. Minimumi absolut e temperaturave ka arritur deri në afër -24°C, kurse maksimumi absolut në 39.6°C (Pukë).

Zona Pukë-Mirditë është një nga më të lagështat në Shqipëri, çka lidhet me reliefin e lartë dhe hapjen nga ana e perëndimit, nga vijnë erërat e lagështa detare. Sasia mesatare e reshjeve është mbi 2000 mm. Kështu në Narelë, që është një nga viset më të lagështa të Shqipërisë, bie sasia maksimale prej 2222 mm, në Fierzë 2149 mm, në Iballë 2180 mm, në Pukë 2025 mm, dhe- në Korthpulë 1892 mm. Rreth 67% e sasisë së reshjeve bie në gjysmën e ftohtë të vitit. Reshjet kanë karakter rrebeshi, që shprehet në maksimumin 24 orësh me vlerë deri 204 mm. Një pjesë e madhe e këtyre reshjeve bie në formën e dëborës lartësia mesatare e së cilës arrin nga 30-200 cm.

Relievi malor dhe sasia e madhe e reshjeve atmosferike, kanë kushtëzuar pasuritë e konsiderueshme ujore dhe krijimin e një rrjeti të dendur përenjsh. Në përgjithësi në këtë malësi janë të rralla burimet e mëdha ujore me përashtim të disa burimeve karstike në shpatin lindor të Munellës.

Varfëria e burimeve nëntokësore lidhet me përhapjen e formacioneve magmatike e terrigjene \_që janë të varfra në ujëra nëntokësore për shkak të përshkueshmërisë së pakët të tyre. Shpërndarja e çrrugullt e reshjeve gjatë vitit dhe shkëmbinjtë e lartpërmendor shkaktojne regjimin e çrrugullt te rrjedhjeve ujore. Në stinën e thatë (gjatë verës) shumë . përenj të vegjël thahen, kurse të tjerët kanë një rrjedhje fare të varfër. I vetmi lumë me rreshje më të pasur në malësi është Fani i Madh dhe lumi i Gomsiqes, që kanë rrjedhje të përhershme.

Mbulesa bimore e malësisë Pukë-Mirditë është nga më të pasurat e vendit, e shumëlojshme dhe mjaft e dendur. Ajo dallohet sidomos për masivet e mëdha pyjore. Këtu gjejnë shprehjen e vet të gjithë brezat bimorë, si brezi i shkurreve mesdhetare, i dushkut, i ahut dhe pjesërisht edhe ai i kullotave alpine. Por shtrirjen më të gjerë e ka brezi i dushkut, i cili përha pet në të gjithë periferinë e zonës nga 500-600 m deri 900-1100 m (nga perëndimi e jugu). Pas tij vjen brezi i ahut në të cilin takohen edhe pisha e zezë, veçanërisht në Bjeshkët e Tërbun-Kuzhnenit dhe në Qafën e Malit-Munellë. Ky brez shtrihet sidomos në kurrizin Krab-Kunorë-Dardhë dhe Munellë ku ngrihet mbi pyllin e pishës së zezë. Shkurret mesdhetare dhe kullotat alpine zenë një areal tepër të kufizuar në pjesën perëndimore si në Gomsiqe, Berishë dhe në lartësitë e vogla të Munellës e Tërbun-Kuzhnenit. Masivet më të mëdha pyjore të kësaj malësie dhe njëkohësisht nga më të mëdhatë e vendit tonë, janë Bjeshkët e Tërbun-Kuzhnenit, në Krab-Kunorë-Dardhë dhe në Tuç-Munellë.

Tipat mbizotërues të tokave të zonës janë, tokat e kafenjta, të cilat duke u zhvilluar në formim e amnore ultrabajzike janë të pasura me kripëzëm magnezial. Pas tyre vijnë tokat e murrme pyjore, të cilat shtrihen në brezin e ahu t e të pishës midis

1200-1800 m lartësi. Tokat livadhore malore kanë shtrirje tepër të kufizuar në kuotat më të larta të kësaj malësi e, veçanërisht në kurrizin e Munellës dhe të Tërbun-Kuzhnénit. Krahas këtyre këtu takohen dhe toka primitive, të cilat shtrihen në areale tepër të kufizuara në rrëpirat e Munellës e të maleve të tjera, në zallishtoret e lumit Fani i Madh dhe të përrrenjeve të shumtë të malësisë. Tokat bujqësore shtrihen kryesisht në tarracat, deluvionale dhe ato lumore që ndodhen në brezin e tokave të kafenjta. Ato kanë nevojë për kullim dhe gëlqerizim, sepse janë të pasura me kripëra të magnezit.

### Lugina e Fanit te Madh

Lugina e Fanit të Madh më e madhja e Malësisë së Mirditës, shtrihet thuajse në pjesën qendrore dhe më të lartë të saj, në një gjatësi rreth 60 km dhe drejtim të përgjithshëm verilindje-jugperëndim. Ajo nis nga Qafa e Malit dhe derisa përfundon në pellgun e Rrëshenit, rrethohet nga vargmalet Krrab-Kunorë-Dardhë. në veri, Bjeshkët e Tërbun-Kuzhnénit në perëndim dhe nga Munella në lindje.

Lugina shtrihet nga lartësia rreth 180 m në bashkimin me Fanin e Vogël deri në 1000 m në fillimet e saj, por lartësia mesatare është 800 m.

Pjesa më e madhe e saj ndërtohet nga shkëmbinj magmatikë e efuzivë dhe pjesërisht gabroidë dhe ultrabajzikë që janë tepër të shkatërruara nga thyerjet tektonike, të cilat i kanë dhënë përgjithësisht origjinë tektoniko-erozive. Midis këtyre thyerjeve përmendim atë midis Qafës së Malit dhe asaj të Rrapës me drejtim verilindje-jugperëndim si dhe thyerjen midis kontaktit të shkëmbinjve efuzivë me ata ultrabajzikë me drejtim thuajse veri-jug.

Megjithatë rolin më të rëndësishëm në evolucionin morfolojik dhe në drejtimin e përgjithshëm VP-JL të kësaj lugine e ka luajtur struktura grabenore e Rrëshenit në JP, ku ajo përfundon. Ulja e vazhdueshme e këtij grabeni e ka detyruar lumin e Fanit e të Madh ta thellojë e ta shtrijë luginën e vet përgjatë strukturave në ngritje e sipër të malësisë së Pukë-Mirditës. Gërryerja e Fanit përqendrohet kryesisht në shpatin e majtë të luginës për shkak të ngritjes neotektonike më të mëdha që pëson struktura e Munellës në krahasim me masivet ultrabajzike që shtrihen në të djathë të saj. Copëtimi horizontal arrin vlera të mëdha (3-5 km/km-) dhe shumë të mëdha (mbi 5 km/km-), veçanërisht në sektorin e mesëm (midis Kaolinës dhe Gjegjanit). Kjo lidhet me përbërjen kryesisht prej formacionesh efuzive, pjerrësinë e madhe të shpatave dhe me sasinë e madhe të reshjeve.

Energjia e reliefit përgjithësisht merr vlera mesatare (100- 300 m/km-) kur lugina kalon nëpër shkëmbinj efuzivë dhe më rrallë vlera të mëdha (300-500 m/km-) kur kalon nëpër shkëmbinj gabroidë dhe ultrabajzikë.

Duke u nisur nga ndryshimet morfolojike brenda malësisë Pukë--Mirditë në luginë veçohen 2 sektorë: sektori i sipërm, midis Qafës së Malit dhe fshatit Kaolinë dhe sektori i mesëm deri në fshatin Simon.

Sektori i sipërm i luginës është formuar në thyerjen tektonike Qafa e Malit-Rrapës, e cila ka përcaktuar si origjinën (tektoniko- erozive), ashtu edhe mjaft tipare

morfologjike të saj. Deri në Fushë-Arrëz lugina është tipike në formë «V», me shtrat të ngushtë dhe shpatet gati simetrike dhe tepër të copëtuara nga degët e shumta. Dy zgjerimet që pëson lugina këtu janë shkaktuar nga grykëderdhja e përroit të Kryeziut dhe atij të Micoit nga e djathta e saj. Duke filluar nga Fushë-Arrëzi lugina vjen e zgjerohet dora-dorës derisa arrin kulmin në fshatin Kaolinë, pikërisht atje ku ajo kthehet menjëherë për nga jugu. Ky zgjerim, që shënon dhe mbylljen e këtij sektori, është formuar në kryqëzimin e dy thyerjeve që u përmendën më lart. Shpati i Djathtë i luginës në këtë sektor është mjaft i butë, sepse është formuar në një vend shumë të shkatërruar nga ana tektonike, kurse ai i majtë është mjaft i pjerrët dhe gati i zhveshur nga proceset erozivo-denuduese.

Mbas zgjerimit të Kaolinës fillon sektori i mesëm i luginës, gjatë të cilit ajo i ndryshon mjaft tiparet morfologjike të saj. Deri në fshatin Gojan e Epërm lugina ngushtohet përsëri, sepse formacionet efuzive u lëshojnë vendin atyre gabroide e ultrabazike, të cilat janë më të qëndrueshme ndaj gërryerjes.

Shtrati i luginës arrin në këtë sektor 15-20 m gjërsi duke formuar meandrine të shumta, kurse shpatet janë të pjerrëta, veçanërisht ai nga e majta, që merr tiparet e rrëpirave erozive. Këto meandrine shpjegohen jo vetëm me ndryshimet litologjike (gabrot dhe efuzivët), por edhe me materialet e shumta që depozitojnë degët e Fanit të Madh në këtë pjesë të luginës. Pas fshatit Gojan e deri në Gjegjan lugina zgjerohet përsëri jo vetëm nga konet e depozitimit të degëve të saj, por edhe nga shkatërrimi i fuqishëm i shkëmbinjve efuzivë. Pikërisht në Gjegjan është formuar dhe një kon i madhë depozitimi nga dega e majtë e saj (përrroi i Gjegjanit). Në këtë sektor janë të zhvilluara më mirë se kudo në këtë luginë deri në tre nivele tarracash gati tërësisht nga e djathta e saj. Në dalje të fshatit Gjegjan e deri në fshatin Simon, lugina shtrihet thuaqse tërësisht në një relief të butë kodrinor me lartësi 400-700 m që formohet mbi pragun stukturor ultrabazik Kuzhnen-Buk- mirë. Lugina ngushtohet shumë derisa merr tiparet e grykave me gjarpërimë të theksuara dhe shpatet gati të rrëpirta. Duke filluar pak në lindje të grykëderdhjes të përroit të Shpërdhazës e deri ne bashkimin me Fanin e Vogël lugina trajtohet në gropën e Rrëshenit.

Tokat më të përhapura në luginë janë ato të kafenja malore që shtrihen nga 400-900 m lartësi. Vetëm në lartësitë më të mëdha (900-1100 m) në sektorin e sipërm takohet një sipërfaqe e vogël toka sh të murime pyjore. Të përhapura janë edhe tokat primitive, të cilat shtrihen në pjesët e rrëpirëta e të zhveshura të shpatave si dhe në zallishtoren dhe tarracat lumor e të luginës.

Mbulesa bimore e luginës nuk është shumë e pasur dhe përfaqësohet kryesisht nga dy kate, ai i shkurreve mesdhetare dhe i dushkut. Katër i parë, në të cilin takohen disa illoje makjesh (shqopa, mareja), shtrihet tërësisht në sektorin e poshtëm midis fshatit Simon e deri në grykëderdhje në lartësinë 200-400 m. Kurse katër i dushkut, i cili është mbizotëruar, shtrihet nga 500-900 m, duke u përzier dhe me pishën e zezë në sektorin e mesëm e pjesërisht të sipërm të luginës. Në afërsi të Qafës së Malit takohet një areal i ngushtë ahu midis 900-1100 m lartësi.

### Pamje nga zona ku do te ndertohet HIDROCENTRALI I GOJANIT




Zona e vepres se marjes ne lumin Fan




Perroi i Shtelles



Hyrja e tunelit te sjelljes



Zona ku parashikohet hyrje me galeri ne tunelin e sjelljes



Zona ku parashikohet hyrje me galeri ne tunelin e sjelljes



Zona ku parashikohet baseni me presion dhe  
tubacioni i turbinave




Zona ku parashikohet te vendoset ndertesa e centralit

## 2.6. Zonat e Mbrojtura


Ne territorin e Bashkise Puke nuk ka zona te mbrojtura. Por, referuar VKM Nr.676, date 20.12.2002 jane percaktuar monumentet natyrore qe shtrihen ne territorin e Bashkise Puke.

Nr.	Emertimi	Gjendja aktuale
1.	Shpella e Kaurit	Shume mire
2.	Fosilet e Kçires	Mire
3.	Penelopa e Gomsiqes	Mire
4.	Guri i Shenje	Shume mire
5.	Geshtenjat e Kokdodit	Mire
6.	Bungat e varrezavve ne Korthpule	Mire pjeserisht
7.	Mrizi i nderlugjeve	Mire
8.	Mani i zi	Mire pjeserisht
9.	Hurdha e Tisit	Mire
10.	Karsti i Munelles	Mire
11.	Akacjet e Migjenit	Mire



Zonat e Mbrojtura në Shqipëri,  
Strategjia e Biodiversitetit dhe Plani i  
Veprimit (2000)

### Shpella e Kaurit



Eshtë një shpellë që i përket zonës Qelëz, të Bashkisë Pukë. Shpella ndodhet pranë fshatit Lëvrušk, në malin Kollata. Besohet të jetë një kasolle për heremitët. Ka të ngjarë të jetë përdorur nga ushtria si një pikë vëzhgimi.

### Fosilet e Kçirës

Eshtë një zonë me përqëndrim fosilesh. Ajo është e vendosur në fshatin Kçiraj, 600 metra mbi nivelin e detit. Dallohen disa lloje të njoitura të fosileve të tilla si: Sagaceras albanicum, Pronorites osmanicus, Procarnites skanderbegis dhe të tjera. Ka një interes të veçantë në fushat e gjeologjisë dhe gjeografisë. Ky përqendrim i fosileve mbulon një sipërfaqe prej 4500 m<sup>2</sup>. Për të vizituar këtë monument, duhet të ndjekësh rrugën automobilistike Shkodër-Pukë dhe të vazhdosh në kryqëzimin e vendbanimit Kçiraj.


### Peneplena e Gomsiqes



Bëhet fjalë një pllajë pranë Gomsiqes, 800 metra mbi nivelin e detit. Plaja u krijuar mijëra vjet më parë për shkak të erozionit dhe lëvizjes së pllakave tektonike. Eshtë një monument i rëndësishëm natyror, pasi ka një vlerë të lartë shkencore, ekologjike dhe kulturore. Qasja bëhet nëpërmjet rrugës automobilistike Shkodër – Pukë.

### Guri i Shenjtë

Ndodhet pranë fshatit Zezaj, në lindje të Pukës, në 538 metra mbi nivelin e detit.




Eshtë një shkëmb granit në formë të një poligoni. Ka pasur disa mite dhe histori rreth këtij monumenti natyror, duke i dhënë atij një rëndësi të veçantë. Disa thonë se është e lidhur, sipas mitit, me Skënderbeun, sepse thuhet se mbi shkëmb ndodhet një gjurmë e thundrës së kalit të tij. Ka interes shkencor dhe kulturor. Mund ta vizitosh atë nëpërmjet rrugës Pukë – Zezaj. Pranë shkëmbit

ndodhet Kalaja mesjetare e Lekë Dukagjinit e ndërtuar në shekullin e 15-të.

### Gështenja e Kokdodit

Është një pyll gështenjash, 980 metra mbi nivelin e detit, pranë fshatit Kokdodit.



Pylli ka një sipërfaqe prej përafërsisht 10 ha drurit gështenje të egër. Ka formë te parregullt dhe është në gjendje të mirë pavarësisht nga sëmundjet qe i shkaktohen pemëve. Lartësia e pemëve është 10-15 metra, dhe mosha e tyre është mbi 100 vjeçare. Është një monument i rëndësishëm natyror për shkak të vlerës ekologjike, shkencore, ekonomike dhe turistike. Është i arritshëm përmes pikës së përbashkët Pukë – Iballë – Kokdodë.

### Bungat e varrezave në Korthpulë

Kjo zonë e mbrojtur ka të bëjë me dy pemë që gjenden në Varrezat e fshatit Korthpulë, 500 metra mbi nivelin e detit. Këto pemë lisi janë mbi 15 m të larta dhe mbi 300 vjet të vjetra. Me degët e tyre mbulojnë të gjithë varrezat. Ka vlerë shkencore, estetike dhe gjithashtu turistike. Qasja është e mundur përmes rrugës që lidh Pukën dhe vendbanimet Gomsiqe – Korthpula.

### Mrizi i Ndërlugjeve



Këto janë 4 pemë (pemë lisi) të vendosura pranë njëra-tjetrës, me një lartësi prej 10-15 metrash. Ato ndodhen në një lartësi prej 800 metra mbi nivelin e detit, pranë fshatit Meçe, në zonën Rrapë. Mosha e tyre është rrreth 200 vjeçare. Ka interes shkencor, estetik dhe turistik. Monumenti mund të vizitohet nga rruga që lidh fshatin Meçe me qytetin e Pukës.

### Mani i Zi

Ndodhet në periferinë jugperëndimore të qytetit të Pukës, në një lartësi prej 800 metrash mbi nivelin e detit. Ai është një man i zi i veçantë, 9 metra i lartë dhe rreth 400 vjeçar. Ruhet në gjendje të mirë. Ka një vlerë të veçantë shkencore, historike, fetare dhe turistike. I ndodhur në periferi të qytetit të Pukës, është lehtë i arritshëm në pak minuta.




### Hurdha e Tisit

Ndodhet në luginën Gomsiqe pranë fshatit Pezhë në qarkun e Pukës. Ka një lartësi prej 650 metrash mbi nivelin e detit. Është një pemë halore, në një zonë shkëmbore që është në gjendje shumë të mirë. Mosha e saj është rreth 250 vjeçare. Është me interes shkencor dhe turistik. Nuk është lehtësisht e arritshme, pasi kushdo që dëshiron ta vizitojë duhet të ndjekë një rrugë të paasfaltuar që tëçon atje.

### Karsti i Munellës

Janë formacione karstike të vendosura 1800-1990 metra mbi nivelin e detit, pranë fshatit Tuç. Është një peizazh karstik me shumë pellgje dhe kavite, i cili formohet natyrshëm nga ujrat dhe shkëmbinjtë gëlqerorë të Malit Munella. Në male ka një bimësi barishtore dhe livadhe të shumta. Ka interes shkencor, estetik, turistik dhe ekonomik. Për ta arritur ndiqet rrugëtimi Fushë Arrës - Tuç - mali i Munellës.



### Akacjet e Migjenit

Bëhet fjalë për akacie, të vendosura në Muzeun e Migjenit, në qytetin e Pukës. Ato kanë rëndësi historike, ndërsa thuhet se nën hijen e tyre, vdiq poeti Migjen.



35

### III. INFORMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE, NENSIPERFAQEN E KERKUAR NGA PROJEKTI DHE NE AFERSI TE TIJ


#### 3.1. Pershkrim i pergjithshem i Pellgut Ujor

Vendin kryesor në malësi e Puke –Mirdites e zë reliivi lumor për shkak të zhvillimit të madh të rrjetit hidrografik. Ngritjet më të mëdha në qendrat e kësaj malësie kanë bërë që drejtimi kryesor i rrjetit hidrografik të ketë një shpërndarje rrezore. Në sektorët ku përrrenjtë çajnë shkëmbijtë magmatikë dhe gëlqerorë luginat formojnë gryka të ngushta dhe gjarpërime të shumta. Në sektorë të tjera fundi i luginave është i gjerë dhe zallishtor, veçanërisht kur kalojnë nëpër shkëmbinjtë e shkatërruar efuzivë e terrigjenë. Të tillë mund të përmendim sektorin e poshtëm të luginës së Gominës dhe përroin e Micoit. Ndonjë luginë si ajo e Gomsiqes kalon tërthor strukturës duke marrë karakterin e një lugine tërthore. Takohen lugina të formuara përgjatë shkëputjeve tektonike (lugina e Fanit të Madh dhe e Gominës) dhe lugina antiklinale (e Lumin të Zi etj). Në shpatet e luginave janë të përhapura në forma fragmentare tarracat lumore. Numërohen deri në tre nivele tarracore. Në grykëderdhjet e disa përrenjve, si ai i Gjadrit dhe i Gomsiqes, janë formuar edhe kone depozitimi me pamjen e fushave proluviale.


Veçoritë klimatike të Malësisë Pukë-Mirditë janë kushtëzuar nga pozita gjeografike në veri të vendit, largësia nga deti, lartësia (mbi 1500 m) dhe copëtimi i theksuar i reliefit të saj. Në përgjithësi klima e zonës është mesdhetare malore me dimër të ashpër dhe të ftohtë dhe verë relativisht të freskët.

Pellgu ujëmbledhës i lumit të Fanit të Madh shtrihet në Malësinë e Mirditës në pjesën qëndrore dhe më të lartë të saj. Lugina e Fanit të Madh ka një gjatësi rreth 60 km me drejtim të përgjithshëm verilindje-jugperëndim. Ajo nis nga Qafa e Malit dhe

derisa përfundon në pellgun e Rëshenit, rrrethohet nga vargmalet Krrab – Kunorë-Dardhë. Fani i Madh ka një pellg ujëmbledhës prej 542 km<sup>2</sup>, ndërsa sipërfaqja deri në aksin e hidrocentralit është rreth 198 km<sup>2</sup>. Që nga burimi në Qafën e Malit dhe derisa bashkohet me lumin e Fanit të Vogël ruan një drejtim të përgjithshëm. Ka një gjatësi 79.6 km dhe lartësi mesatare rreth 800 m mbi nivelin e detit.



36





Pellgu ujëmbledhës i lumbit të Fanit të Madh shtrihet në Malësinë e Mirditës në pjesën qendrore dhe me të lartë të saj. Lugina e Fanit të Madh ka një gjatësi rreth 60 km me drejtim të përgjithshëm verilindje-jugperëndim. Ajo nis nga Qafa e Malit dhe derisa përfundon në pellgun e Rreshenit, rrrethohet nga vargmalet Krrab-Kunore-Dardhe. Kjo lugine shtrihet nga lartësia rreth 180 m mbi nivelin e detit, në bashkimin me Fanin e Vogël, deri në 1500-1600 m në fillimet e saj.

Fani i Madh ka një pellg ujëmbledhës prej 542 km<sup>2</sup>. Që nga burimi në Qafen e Malit dhe derisa bashkohet me lumin e Fanit të Vogël ruan një drejtim të përgjithshëm verilindje-jugperëndim. Në Fanin e Madh derdhen një sërë degësh, midis të cilave përmendim përroin e Kryeziut, të Micoit, të Shperdhazës dhe të Dibrit nga e djaththa si dhe përroin Lumi i Zi dhe ate të Kalivares nga e majta.

Pjesa me e madhe e pellgut ujëmbledhës të Fanit të Madh përbëhet nga shkëmbinj magmatike e efuzive dhe pjesërisht ultrabajzike që janë tepër të shkatërruara nga thyerjet tektonike, të cilat i kanë dhënë përgjithësisht origjine tektonike-erozive. Copëtimi horizontal i kësaj lugine arrin vlera të mëdha (3-5 km/km<sup>2</sup>) dhe shume të mëdha (mbi 5 km/km<sup>2</sup>), veçanërisht në sektorin e mesëm midis Kaolines dhe Gjegjanit. Kjo lidhet me përbërjen kryesisht prej formacioneve efuzive, pjerrësinë e madhe të shpateve dhe me sasinë e madhe të reshjeve.

Duke u nisur ndryshimet morfoloqjike brenda malësisë Pukë-Mirditë në luginën e Fanit të Madh dallohen dy sektorë: sektori i sipërm midis Qafës se Malit dhe fshatit Kaolinë dhe sektorit të mesëm deri në fshatin Simon.

Sektori i sipërm i luginës është formuar në thyerjen tektonike Qafa e Malit-Rrapes, e cila ka përcaktuar si origjinën ashtu edhe mjaft tipare morfoloqjike të saj. Deri në Fush Arrëz lugina është tipike në forme "V" me shtrat të ngushte dhe me shpate gati simetrike dhe tepër të copëtuara nga degët e shumta që përfundojnë në Fanin e Madh. Dy zgjerimet që peson lugina këtu janë shkaktuar nga grykëderdhja e përroit të Kryeziut dhe atij të Micoit nga e djathta e saj. Duke filluar nga Fush Arrëzi lugina fillon e zgjerohet gradualisht deri në fshatin Kaolinë.

Mbas zgjerimit të Kaolines fillon sektori i mesëm i luginës gjate të cilit ajo i ndryshon mjaft tiparet morfoloqjike të saj. Deri në fshatin Gojan i Epërm kjo lugine ngushtohet përsëri dhe arrin deri në 15-20 m gjëresi. Pas fshatit Gojan deri në e deri në Gjegjan lugina e Fanit të Madh zgjerohet përsëri.

## IV. INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE TE MUNDSHME NEGATIVE NE MJEDIS TE PROJEKTIT

### 4.1. Vleresim i pergjithshem

Ky vlerësim kryhet në bazë të ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" dhe kërkesave të VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së trasferimit të vendimit të deklaratës mjedisore" dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qëllim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nga ndertimi dhe funksionimi i një aktiviteti konsistojne ne vija te pergjithshme si me poshte:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Shkarkimet ne uje
- Ndikimi ne toke
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e prodhuara
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones
- Ndikim ne ndryshimet klimatike

Vleresimi i ndikimit ne mjedis i një projekti te propozuar zhvillimi, eshte vleresimi i ndikimeve te rendesishme, te mundshme, te asaj veprimtarie ne mjedis. Gjate procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis kryhen identifikimi, pershkrimi dhe vleresimi ne menyren e duhur i ndikimit ne mjedis te një veprimtarie, te referuar ne paragrafin e mesiperme, duke percaktuar efektet e mundshme te drejtperdrejta dhe jo te drejtperdrejta mbi token, ujin, detin, ajrin, pyjet, klimen, shendetin e njeriut, floren dhe faunen, peisazhin natyror, pasurite materiale, trashegimine kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre te ndersjellta.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis zbaton parimin e parandalimit qe ne fazen e hershme te planifikimit te projektit, me qellim shmangien apo minimizimin e efekteve negative ne mjedis, permes harmonizimit dhe pershtatjes se saj me kapacitetin bartes te mjedisit. Vleresimi i ndikimit ne mjedis kryhet nga zhvilluesi, si pjese e perqatitjeve per planifikimin e nje projekti zhvillimi dhe para kerkimit te lejeve perkatese te zhvillimit. Ne baze te ketij vleresimi, institucioni perqegjes per mjedisin, merr ne shqyrtim dhe kryen verifikimet perkatese per lejimin ose jo te zhvillimit te nje aktiviteti te caktuar. Institucioni perqegjes per shqyrtimin e dokumentacionit dhe aprovimin ose jo te lejes mjedisore para vendimarrjes se tij, konsultohet edhe me institucionet te tjera te cilat kane lidhe te drejteperdrejte ose jo te drejtperejte me projektin ose ndikohen nga ky i fundit. Konsultimi eshte edhe me i gjere me publikun e ndikuar dhe palet e interesit.

Vleresimi i ketij projekti do te behet per tre fazet kryesore te tij, te cilat jane :

1. *Faza e projektimit*
2. *Gjate ndertimit.*
3. *Gjate funksionimit*
4. *Pasi perfundon se funksionuari.*

#### Ndikimi Projektit te HEC GOJAN gjate Fazes se Ndertimit

Ndikimet i klasifikojme sipas fazave te zbatimit te projektit dhe natyres se tyre dhe mund ti'i ndajme:

- Ndikime peisazhi: nga germimet e tokes per hapjen e rruges, nga ndertimi i veprave te marrjes, ndertimi i traseve te derivacionit me tubacion dhe te tubacioneve ne presion, godines se HEC-it, etj
- Ndryshime ne regjin e ujrate siperfaqesore dhe nen tokesore
- Zhurma, pluhuri dhe gazrat e djegies se motorreve te mjeteve te punes
- Zhvendosje e nje sasie te madhe zhavori dhe dheu te cilet parashikohen te shfrytezohen
- Demtimi i bimesise dhe fondit pyjor

#### Ndikimi i projektit te HEC GOJAN gjate fazes se shfrytezimit

Ndikimet gjate fazes se shfrytezimit klasifikohen ne:

- zhurma e turbinave dhe gjeneratoreve gjate punes se hidrocentraleve
- probleme erozioni pasi probleme te tilla jane prezente per shkak te terrenit

Keto mendohet te zgjedhen me perfundimin e fazes se ndertimit me mbjellen e fidaneve dhe ruajtjen e brigjeve te lumenit prane zones se projektit. Disa elemente te cilesise se jetes dhe mjedisit qe preken nga ndikimet e projektit paraqiten ne menyre me te detauar me poshte. Punicet qe do te realizohen kryesisht gjate periudhes se zbatimit te projektit, vleresohet se do te shkaktojne ndikime ne mjedisin rrotull te cilat jane te domosdoshme te vleresohen ne kuadrin mbrojtjes se mjedisit.

## 4.2. Vleresim i ndikimeve te mundshme

Për të vlerësuar identifikimet e bëra është realizuar analiza e gjëndjes dhe situatës që do të zhvillohet projekt i një fazat e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të këtij hidrocentrali. Për zvogëlimin e ndikimeve në mjedis gjatë fazës së ndërtimit dhe shfrytëzimit të hidrocentralit do të implementohet plani i menaxhimit mjedisor (PMM). Të gjitha punimet do të realizohen në perputhje me këtë plan.

### 4.2.1. Ndikimet në mjedis gjatë ndërtimit të veprave të marrjes se ujit dhe godinës së hidrocentarit

Për ndërtimin e këtij hidrocentrali do të bëhen: gërmime, ndërtim kanali, shtrirë të tubacioneve, rrugë të rangut të tretë, përdorim të makinerive gërmuese dhe transportuese, ndërtimi godinës, vendosja e tubacionit metalik, etj. Do ketë pak zhurmë e pluhur, por pa ndikim shqetësues për njerëzit dhe faunën e egër, madje kjo është shumë e përkohshme

### 4.2.2. Ndikimet në mjedis gjatë përgatitjes së veprës marrëse dhe kalimit të ujit në hidrocentral

Ndikim në mjedis ka dhe ndertimi i veprës hidrike. Per shkak të punimeve të germimit do të ketë shpërndarje të pluhurit në sasira shumë gërmimit. Kjo do të ndodh në hapjen e kanalit me makinerinë përkatëse. Dherat do hidhen pranë kanalit dhe nuk sjellin shqetësim, pasi sasia nuk është e dukshme.

Nje pjese e materialit te germuar do te perdoret per mbushje dhe rehabilitim dhe mbulim te Kanalit te hapur te derivacionit pa presion nga Vepra e marrjes deri ne Basenin e Presionit.

Do te kryhet sistemimin dhe skrapatesh dhe sasia tjeter mendohet te grumbullohet ne nje sipërfaqe te caktuar e cila do te jete prane godines se centralit pasi do te perdoret dhe si sipërfaqe per nenstacionin e ri qe do te ndertohe.

Sic shihet nga tabela volumi i germimeve duhet menaxhuar duke patur parasysh qe te mos preken kriteret e mjedisit perreth, por njekohesisht te gjenden vende dhe pozicione sa me afer veprave per depozitim e tyre, sepse ne te kundert do te rritej kosto e transportit dhe kosto totale e vepres. Nje pjese e mire e volumeve te germimeve do te nevojiten per mbushjen serish te kanalit te tubacionit ku rrëth 1 m lartesi nga shtresa e zhavorit te kanalit gjate gjithe gjatesise se tij do te jete e mbushur me material te ngjeshur nga germimet. Pervec kanalit te tubacionit te turbinave, nje pjese e mire e volumeve nga germimet do te hidhen dhe do te ngjeshen ne muret anesore te veprave si veper marrje, dekantues e basen presioni.

<b>TABELA E VOLUMEVE TE GERMIMEVE PER HEC GOJAN (m<sup>3</sup>)</b>	
<b>Emertimi</b>	<b>HEC GOJAN</b>
Vepra e marrjes	7000
Kanali ushqyes	5500
Dekantuesi	9000
Tuneli i sjelljes germime siperfaqseore	15000
Tuneli i sjelljes germime nentokesore	115000
Baseni i presionit	20000
Tubacioni i turbinave	20000
Godina e HEC	6500
<b>VOLUMI TOTAL</b>	<b>169,000</b>

#### 4.2.3. Ndikimet në mjedis gjatë thellimit dhe hapjes së kanalit te derivacionit

*Ndikimet në mjedis nga sjellja e materialeve të ndryshme për ndërtimin e veprës.* Proceset e punës për ndërtimin e hidrocentralit do të realizohen nga makineri e paisje të ndryshme: gërmimi, hapja e kanali, bërjen, transportin e derdheja betonit, për të transportuar materialet e ndërtimit dhe paisjet e hidrocentralit. Nuk mund të bëhet fjalë për mjete e rritje trafiku, rritje zhurmash, ndotj si dhe nivelin e zhurmave, ndotje ajri etj.

#### 4.2.4. Vlerësimi i efektivitetit të pritshëm të masave zbutëse

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në këtë projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli dhe monitorimi, përmirësimi i vazhdueshem, sipas kushteve të krijuara gjatë aktivitetit, do të çojë ne realizimin dhe përfitimet e masave të parashikuara në projekt.

#### 4.2.5. Zhurmat

Gjatë ndërtimit të hidrocentralit do të ketë zhurmë te moderuar prej makinerive të gërmimit, transportit të materialeve, etj. Kjo më shumë për hapjen e kanalit te derivacionit pa presion me lug, por edhe gjate hapjes se trasese dhe pilotave gjate kalimit te tubacionit te turbinave. Gjate fazes se zbatimit te punimeve, do t'i sugjerojme subjektit qe orari i punes te mos jete pertej ores 18:00. Automjetet dhe mjetet germuese duhet te jene te tilla qe te permbushin standartet e leshimit te zhurmave ne mjedis per te siguruar nje nivel minimal te zhurmave. Mjetet nuk kanë nevojë të përdorin boritë edhe gjate transportit, etj. Zhurma është e përkohshme dhe e tillë është dhe shqetësimi i faunës ë egër. Punëtorët duhet te pajisen me mjetet mbrojtëse ndaj zhurmave.

Pamvaresisht se hidrocentrali do të ndertohej larg zonave të banuara, per të zbutur efektin e trafikut të ngarkuar dhe të zhurmave qe shoqerojne ate, si rruge të perkohshme do të perdoren, kur të jete e mundur rruget dyesore.

Transporti i materialeve, veçanerisht të ndertimit, ne rruget ekzistuese do të programohet duke patur si qellim kryesor shmangjen e shqetesimeve ne trafikun lokal. Gjate nates mjetet e transportit do të operojne me shpejtesi të ulta dhe do te ndalohet perdorimi i borive.

Gjate fazes se shfrytezimit, çeshtja e zhurma eshte e pa perfillshme, pasi te tilla kemi vetem ne godinen e HEC-it tek turbinat e cila eshte larg zonave te banura Niveli i lejueshem i zhurmes varet nga popullsia lokale ose shteti te izoluar afer centralit elektrik. Zhurma vjen kryesisht nga turbinat dhe perspektuesit. Ne ditet e sotme, zhurme brenda ne central elektrik mund te reduktohet, nese e nevojshme, ne nivele ne fushen e 70 dBA, pothuajse i padukshem kur jashte. Ne lidhje me ndikimin e zhurmave, eshte marre si shembull hidrocentrali (Fiskeby ne Norrkoping, Suedi), icili eshte nje shembull per t'u ndjekur, ku pronari kishte kerkuar nje zhurme maksimale te brendshem ne nivelin e 80 dBA ne funksionimin e plotë, gjate nates, ishte vendosur ne 40 dBA ne. Per te arritur keto nivele te zhurmes u vendos qe te gjithe komponentet (turbinat, perspektuesit dhe gjeneratore) do te bliheshin ne nje pakete nga njeprodhues i njohur.

Kontrata e blerjes duhet te kete te percaktuar nivelin e zhurmes qe duhet te arrihet me xhiro maksimale dhe minimale. Prodhusi duhet te miratoje masat e meposhtme: Tolerances shume te vogel rripat e transmesionit turbine gjenerator, veshje izoluese mbi turbine; uje te ftohje ne vend te ajrit te ftohjes per gjeneratoret dhe nje dizajn te kujdeshem te komponenteve ndihmes.

Si dhe izolimin termik per te gjithe strukturen e godines, ndertimit eshte dhene me izolimin akustik. Rrjedhimisht, niveli arritur te zhurmes doli e ndryshme ndermjet 66 dBA dhe 74 dBA, e cila ne teresi doli 20 dBA me e ulet se mesatarja suedeze per njesite e vogla te central eve hidrike

#### 4.2.6. Ndikimet në ujerat sipërfaqsore

Realizimi i projektit per ndertimin e HEC mbi Lumin Fan i Madh dhe perrenjeve te tjere te tij do te ndikoje ne regjin e ujerave te këtij lumi.

Ujerat e shirave qe bien, duke u bashkuar dhe me ujerat siperfaquesore te perrenjeve te tjere me te vegjel, ushqejne rrjedhjen e lumit Fan i Madh ku do te ndertohej HEC-i.

Projekti nuk do te ndikoje negativisht ne ujerat siperfaquesore qe mund te perdoren nga komuniteti per ujitje.

- Nuk do te kete ndikim domethenes ne ujerat nentokesore sepse nuk do te krijohen basene te medhenj ujore per rregullimin e regjimit te prurjeve.
- Lumi Fan i Madh nuk do te thahet dhe nuk do te krijohen probleme me shtratin e tij te vjeter, sepse do te perdoret vetem nje pjese e sasise se prurjeve te tij. Ne periudhen e veres do te punohet me kapacitet jo te plotë. Nje minimum ujerash (Prurja ekologjike te lumit ne masen e percaktuar me ligj

per prurjen e siguruar 355 ditore) gjate periudhes ujepaket lihet te rrjedhe ne shtratin natyror te lumbit.

- Nuk do te krijohen rreziqe te mundeshme nga projekti per permbytje per popullsine e zones sepse perveç prodhimit te energjise se paster elektrike do te disiplinohen edhe ujerat e ketij lumi.
- Lihet nje prurje e konsiderueshme, e quajtur prurja ekologjike, te rrjedhe ne shtratin natyror te Lumit. Ketu perfshihet edhe kontributi i perrenjve te tjere me te vegjel pas veprave se marrjes te HEC-it.
- Nuk do te krijohen rreziqe te mundeshme nga projekti per permbytje per popullsine e zones sepse perveç prodhimit te energjise se paster elektrike do te disiplinoje edhe ujerat ne kete segment te lumbit.

Zbatimi i ketij projekti nuk le shkas per ndotjen e ujrale rrjedhes siperfaqesore nga ndotes te ndryshem si karburante, lende helmuese, etj. Mjetet e transportit do te jene te kontrolluara nga kontrolli teknik i organeve shteterore, gje qe ben moslejimin e qarkullimit te mjetit me te meta tekniqe. Per rastet aksidentale te cilat mund te shoqerohen me derdhje te karburantit apo te vajit, sasia do te jete shume e vogel dhe ato do te derdhen ne toke. Per keto raste subjekti ka planifikuar nje punonje, i cili do te meret me grumbullimin e ketyre ndotesave dhe depozitimin e tyre ne vendin e caktuar.

#### 4.2.7. Ndikimi ne ujrat nentokesore

Tektonika dhe çarmeria e zhvilluar ne keto formacione shkembore kane bere te mundur qe ujembajtja e tyre te jete deri diku e mire. Ujrat nentokesore qe takohen ne zonen e ndertimit te HEC GOJAN, jane ujra te tipit te çarjeve te ndershtresezimeve. Ujrat nentokesore qarkullojne ne drejtim te thellesise kryesisht ne formen e rrymave ujore te koncentruara neper çarje dhe ndershtresezime.

Burimet e ujit kane debit te vogel. Burim furnizimi per ujerat nentokesore jane rreshjet atmosferike ne formen e shiut dhe debores te cilat ne kete zone jane te zhvilluara. Ndërtimi i hidrocentraleve dhe materialet qe perdoren nuk prodhojnë lëndë, te cilat te depertojne ne ujrat nentokesore. Proseset e punës nuk kanë shkarkime te elementeve ndotës te tokës, ujërave etj.

### 4.3. Përdorimi i tokës

Toka eshte element qe peson ndryshime gjate zbatimit te cdo projekti, perfshi edhe ndertimin e HEC-eve. Ndërtimi i HEC GOJAN per nga vete proceset e punës dhe materialet qe perdoren nuk emeton lende helmuese, shkarkime te lengeta te ndotura, apo vajra e karburante te holluara te cilat te depertojne ne ujrat nentokesore. Germimi per ndertimin e kanalit te derivacionit me lug, kanalit per vendosjen e tubacionit te turbinave, betonimi dhe ndertimi i salles se turbinave si dhe vendosja e pajisjeve e makinerive te nevojshme nuk shoqerohet me shkarkime te elementeve ndotës si persa i takon tokes, ujtit siperfaqesor e nentokesor dhe ajrit.

sepse.

- Do te germohet material por do te rikthehet ne fazen e rehabilitimit te terrenit
- Do te kryhen punime betoni (M 150, M200 dhe M250)
- Per HEC GOJAN do te ndertohen veprat e marrjes se ujit, dekantuesi, tuneli i derivacionit, tubacioni i renies se turbinave dhe baseni i presionit. Te gjitha keto shoqerohen me nje volum te konsiderueshem punimesh.
- Do te ndertohen godinat e aggregateve hidroturbogjeneratore + puset e shuarjes se energjise
- Do te montohen dhe do te vendosen ne toke konstruksione metalike, tuba dhe pajisje te tjera celiku dhe plastike.
- Do te perdoret rruget ekzistuese objekti per ne godinen e centraleve dhe per ne nenobjektet komponente te ketij HEC GOJAN
- Do te shtrohet zhavorr dhe do te behen punime te ndryshme si mur guri betonime, dhe risistemime per riformulimin e peisazhit duke e kthyer ate ne gjendjen e meparshme visuale etj.

Ndikimi i punimeve per ndertimin e veprave dhe permasat e nderhyrjeve do te jene te ndjeshme, megjithate keto inerte do te sistemohen ne mjediset me te aferta per te mbushur çarje dhe rreshqitje te ndyshme qe mund te kene ndodhur prej vitesh, duke sherbyer si mbrojtje (argjinature) kunder erozionit nga ujrat dhe duke i zvogeluar pasojat e tij.

#### **4.4. Ndikimi tek njerëzit, ndërtesat dhe objektet të tjera**

##### **4.4.1. Ndikimi në popullsi**

Përfundimi i veprës do të ndikojë shumë pozitivisht tek banorët, duke iu garantuar energjinë elektrike me të gjitha parametrat normale. Ndikim do të ketë edhe në punësimin e banorëve, pavarësisht se është kryesisht i përkohshëm. Permiresimi i sistemit rrugor qe lidh fshatrat perreth do te jete një tjeter perfitim i drejtperdrejte i banoreve te zones.

Realizimi i projektit per ndertimin i HEC GOJAN nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullates se zones. Nga raporti i vepres si planvendosje me komunitetin ben qe vepra te mos influencoje negativisht ne demografine komunitare. Studimi dhe realizimi i tij ka si objektiv kryesor prodhimin e energjise elektrike e cila do te ndikoje pozitivisht ne permiresimin e kushteve te jetesës se komunitetit te zones, duke ju krijuar mundesi punesimi, i cili mund te jete sezonal (gjate ndertimit) ose i perhershëm (gjate shfrytezimit). Vepra do te ndikoje ne fumizimin me energji elektrike duke hyre ne sistemin energjetik kombetar nepennjet nenstacionit me te afert ose duke sherbyer si një garanci energjitetike rezerve per zonen

Projekti do te krijoje mundesine e punesimit te banoreve te zones duke ndikuar direkt ne rritjen e ekonomise se tyre familjare. Me prodhimin e energjise elektrike nga ky projekt, gjithashtu, do te kete zhvillim edhe industria e lehte dhe ushqimore zonale dhe do te zgjerohen edhe sherbimet.

Zona fumizohet me energji elektrike pa nderprerje, por prerjet sporadike te energjise e kane prekur dhe ate rralle here e kryesish gjate dimrit si pasoje e difekteve nga ngricat, e theksuar kjo sidomos ne fshatra. Megjithate, jane bere perpjekje per te permiresuar infrastrukturen e energjise elektrike ne kete drejtim. Ndertimi i ketij HEC - it rrit kapacitetin prodhues te energjise elektrike dhe i vjen me afer kerkesave te banoreve prane tij.

Ndertimi i objektit larg zonave te banuara do te thote qe ky objekt nuk do te shkaktoje shqetesim tek banoret e zones. Perkundrazi ndertimi i hidrocentralit HEC GOJAN do te ndikoje pozitivisht tek banoret e zones duke ju garantuar energjine elektrike me te gjitha parametrat normale.

Njekohesisht duhet theksuar edhe fakti qe ne kete aktivitet mendohen te punesohen nje numer i konsiderueshem punonjesish, duke zbutur sadopak plagen e papunesise e emigracionit ne kete zone.

#### *4.4.2. Ndikimi në peizazh*

Ndërtimi i hidrocentralit do të sjellë ndyshime të peizazhit natyror nëpërmjet: veprës së marrjes së ujit, kanalit te derivacionit, rrugëve, më shumë këmbësore për gjatë këtij kanali; godinës së hidrocentralit, rrugës për tek kjo godinë dhe linjës së trasmetimit të energjisë elektrike. Peizashi nuk do te demtohet nga ndertimi i veprave se ato do te ndertohen ne harmoni me mjedisin ekzistues. Aktiviteti, per vete natyren e punes dhe te nderhyrjes ne mjedis nuk paraqet ndonje ndikim te madh negativ direkt apo indirekt. Zbatimi i projektit per ndertimin e HEC - it do te ndikoje ne peizazhin ku ai do te kryeje aktivitetin e tij. Kjo do te konsistoje ne ate qe projekti shoqerohet me permiresimin e infrastruktures rrugore ekzistuese dhe ruajtjen e brigjeve te lumiit nga erozioni.

#### **4.5. Ndikimet mbi trashëgiminë arkitektonike dhe historiko-arkeologjike**

Deri tashmë nuk ka të dhëna për këtë trashëgimi. Për këtë është folur dhe me specialistët përkatës në rreth e më gjerë. Gjasat janë të mos ketë, pasi është zonë e vështirë për banim. Nëse gjatë punës rezulton një pasuri e tillë, shoqeria ndërtuese duhet që, në përputhje me ligjet në fuqi, të ndalë menjëherë puna dhe të lajmërohen institucionet dhe specialistët përkatës. Në vazhdim, në bashkëpunim me projektuesin gjëndet zgjidhja më e mirë.

Ne zonen e zgjedhur per projektin ne fjale nuk ka habitate apo objekte me status te percaktuar te veçante.

#### **4.6. Ndikimet ne habitatet dhe objektet me status te percaktuar**

Monumentet e kulturës së një qyteti e kombi janë simbole të rëndësishme që tregojnë vlerat materiale, shpirtërore dhe zhvillimin në shekuj dhe vite. Monumentet e kulturës jo vetëm në perëndim, por edhe në vendet ish-komuniste kanë patur dhe vazhdojnë të kenë një vëmendje të veçantë.

#### **4.7. Ulja e intensitetit të erozionit dhe zbutja e ndryshimeve të topologjisë**

Fenomeni i erozionit eshte shume i dukshem ne luginen e lumbrit Fani i Madh ku do te ndertohen veprat e marrjes se HEC GOJAN dhe ne gjithe luginen e lumbrit. Rrymat e ujave siperfaqesore qe grumbullohen ne periudhen e reshjeve masive gerryejne pjesen e perafruar te formacionit rrenjesor dhe materialin e transportojne ne pikat me te ulta te reliefit. Themelet e veprave jane te ekspozuara nga ky fenomen negativ. Ekziston mundesia e veprimit negativ te erozionit ne bazamentin e tubacionit te derivacionit dhe ne vendet e tjera te objekteve te ketij hidrocentrali, ne lidhje me kete duhet te tregohet kujdes te mbrohet tubacioni i derivacionit qe eshte ne germim dhe ne mbushje nga rreziku i gerryerjes. Per kete rekomandojme mbulimin e tubacionit dhe largimin e ujave ne te dy anet e tubacionit dhe mbrojtjne e tij nga erozioni me mure ose masa te tjera.

Njëherazi të parashikohen masa konkrete për të përballuar rastet e shirave të rrëmbyeshëm, që shoqërohen me fryrjen e lumbrit dhe të degëve të tij. Ndër këto masa mund të theksojmë: ndërtimë dhe paisje që e mbajnë nën kontroll sasinë e ujit që hyn në kanalin e marrjes; sistemimet malore, sistemimin e ujërave në shpatë, pyllëzimet e sipërfaqeve të zhveshura etj. Të gjitha veprat hidroteknike vazhdimesht duhet të mirëmbahen.

Degradimi fizik dhe erozioni i tokës mund te jene problem per shkak te terrenit. Sic eshte e shpjeguar edhe ne studimin gjeologjik toka ku do te ndertohej vepra eshte e qendrueshme dhe jane bere llogaritjet e nevojshme qe objektet dhe terreni ku ato do te ndertohen te jene po ashtu te qendrueshme. Ne zonen qe analizohet, projekt i propozuar do te kete impakt pozitiv. Nderhyrjet per ndertimin e veprave do te sistemojne terrenin per shmanine e erozionit (sepse do te jete edhe ne favor te projektit).

Nuk do te kete erozion te tokës dhe do te behet disiplinimi i ujave te lumbrit qe ne periudhe reshjesh masive behen te rrembyeshem. Materialet e germimeve do te depozitoohen ne vende te caktuara ne dakortesi me autoritetin e bashkise si dhe ne respektim te legjislacionit mbi mjedisin. Edhe nga shkarkimi i ujave pas daljes nga turbinat nuk do te kete probleme erozioni, sepse nepermjet nje kanali te shkurter shkarkimi uji i perdorur do te hidhet perseri ne shtratin e lumbrit

Qellimi kryesor i projektit eshte ndertimi i hidrocentralit per te prodhuar energji elektrike. Ne zbatimin e projektit per te ruajtur ekuilibrin mjedisor do te meren keto masa:

- Mirembajtja e veprave hidrotekniche, kanaleve, tuneleve, ndertesave te centraleve etj. per moslejimin dhe parandalimin e permbytjeve nga rrjedha ujore dhe prurjet e ngurta ne rastet e shirave te trembyeshem dhe stuhive te paparashikuara.
- Ne rastet e mesiperme apo ne rastet e avarive do te behet derdhja e ujit direkt ne lume. Gjithashtu ne rastet e avarive te medha jane parashikuar masat parandaluese si shkarkime dhe mbyllje portash.
- Per te parandaluar erozionin do te behet mbjellja e menjehershme ne siperfaqet e zhveshura prane objekteve hidrotekniche. Mbjellja e pemeve ka nje rol te rendesishem se duhet patur parasysh rreziku aktual i erozionit i cili shprehet me kombinimin e indeksit te Rrezikut Potencial te Erozionit (indeksi erodibiliteti X indeksin e erozionit X indeksin e pjerresise) dhe Indeksin e Vegjetacionit (shkalla e mbuleses bimore).

#### 4.8. Ndikimet ne flore dhe faun

Zona ku do te ndertohet HEC-i ka nje ekosistem te pasur dhe te formuar ne aspektin biotik. Veprat do te ndertohen ne nje terren kodrinor-malor. Zbatimi i projektit dhe zhvillimi i tij nuk do te ndikojne negativisht ne menyre sinjifikative ne humbjen dhe demtimin e habitateve si dhe te specieve bimore ne zonat ku studiohet ndertimi i HEC GOJAN. Do te kryhen punime ne zona me bimesi te paket ne forme shkurresh dhe ambientet ku do te behet ndertimi i HEC-it do te pasurohen me gjelberim shtese. Nga projekti do te priten nje sasi e vogel shkurresh dhe vegjetacioni natyror gjate ndertimit te traseve te derivacionit me tubacion, traseve te tubacioneve te renies se turbinave te HEC-it, Keto jane kosto te pranueshme per projekte te tilla qe kane si qellim prodhimin e paster te energjise elektrike me perfitim per ekonomine kombetare dhe sidomos te popullsise se rajonit ku do te ndertohet HEC-i. Kompania investuese krahas zbatimit te projektit inxhinierik do te hartoje nje plan rehabilitimi te zones se projektit, veçanerisht aty ku toka i eshte nenshruar punimeve te germimit.

Fauna e zones perbehet nga lloje natyrore dhe te kultivuara. Demtimi me i madh i faunes, ka ndodhur gjate degradimit te pyjeve ne vitet e tranzicionit. Zbatimi i projektit dhe zhvillimi i tij nuk ndikojne negativisht ne humbjen dhe demtimin e habitateve si dhe te specieve shtazore ne zonat ku ai ushtron aktivitetin e tij, por do te përmirësojë treguesit mjedorë në drejtim të kultivimit të specieve ujore nga komuniteti. Mund te kete ndikim ne faune (e perbere nga zvarranike, urithe, amfibe, shpen- de dhe insekte) gjate fazes se ndertimit te veprave te HEC-it per shkak te trembjes se tyre apo prishjes rastesore te foleve gjate tjetersimit te siperfaqes, por kjo nuk do te ndodhe gjate shfrytezimit te tij.

Per shkak te projektit, mund te kemi nje zvogelim te habitatit te specieve ujore sepse perrenje perbejne nje ekosistem me vlera jetike per shume specie ujore (si amfibe, krimba, bime ujore, etj) te cilet jane pjesa e rendesishme e zinxhirit ushqimor ne

ambientin ujor. Pas ndertimit te veprave, gjate fazes se shfrytezimit, keto dukuri zbehen.

#### 4.9. Humbja e dëmtimi i tipareve gjeologjike, paleontologjike, problem i mjedisit gjeologjik

Degradimi fizik dhe erozioni i tokes mund te jene problem per shkak te terrenit. Siç eshte shpjeguar edhe ne studimin gjeologjik toka ku do te ndertohet vepra eshte e qendrueshme dhe jane bere llogaritjet e nevojshme. Terreni ku ato do te ndertohet objekti te jete po ashtu i qendrueshme. Ne këtë zone qe analizohet, projekti i propozuar do te kete impakt pozitiv.

Nderhyrjet per ndertimin e veprave do sistemojne terrenin per shmangjen e erozionit (sepse do te jete edhe ne favor te projektit). *Nuk do te kete erozion te tokes* dhe do te behet disiplinimi i ujerave te lumbit qe ne periudhe rreshjesh masive behen te rrembyeshem.

Materiale e dala nga germimet , si dekantuesi, tuneli ,baseni me presion dhe tubacioni i turbinave e ndertesa e centralit, do sistemohen prane nenobjekteve perkatese. Ne hyrje te tunelit ne anen e majte te derivacionit ka zone depresioni qe duke u mbushur e sistemuar dherat kthehet ne toke buke. Ato te dala nga tuneli, te cilat dalin ne tre dalje galerishe do sistemohen ne perrenje e thelle. Dheu do perhapet me shtresa dhe do disipklinohet edhe largimi i ujrave. Ne dalje te tunelit dhe basenit me presion germimet mund te sistemohen ne luginen e Kalivarenit ne nje distance deri ne rreth 800-900 m larg.

Per sistemimine e punimeve ambientale si peme e gjelberime te ndryshme jane parashikuar, ne preventiv edhe fondet perkatese.

#### 4.10. Ndikimet e pritshme ne mjedisin perreth

##### 4.10.1. Ndikimet fizike të projektit në ndryshimet e topografise së zonës, të tokës etj

Sipas projektit nga ndërtimi i hidrocentralit ndryshimet e topografisë së reliefit do të janë të papëfillshme. Megjithate janë parashikuar ndërhyrjet e nevojshme, si: masa për parandalimin e erozionin apo rrëshqitjeve të mundshme. Ka kombinim me masa ta tjera që të mos dëmtohet peizazhi dhe bimësia natyrore, pavarësisht se janë dëme të përkohshme dhe të vogla. Terreni ku hapet kanali do ketë sistemime gjatë punës. Dëmtimi i tokës arë është i vogël, kryesisht toka të varfëra, që do të kompesohen etj.

Ne projekt parashikohet nje rradhe pune e tille qe ne kombinim me masat e tjera suplementare te mbushjes, sistemimit dhe trajtirnit te parandalojne fenomenin e erozionit:

- Ndikimet ne perdorimin e tokes dhe te burimeve
- Ne cilesine dhe sasine e tokes are.

Eshte theksuar dhe me siper qe te gjitha punimet do te kalojne ne shkernbinj te zhveshur te shpateve e brigjeve te lugines se Fanit te Madh, duke iu shmangur tokes buqesore. Pamvaresisht se punimet do te kalojne ne keto terrene, nga projektuesit eshte planifikuar qe hap pas hapi te behet sistemirni i terrenit dhe si pasoje zhvillimi i bimesise spontane te meparshme te kesaj zone.

#### 4.10.2. *Ndikimet e projektit në modelin drenazhues të zones*

Sic eshte theksuar me siper, veprat qe do te ndertohen do te jene te kombinuara, duke ruajtur funksionet e meparshme dhe te perspektives lidhur me perdorimin e ujit per qellime ujite te zones perreth. Per pasoje eshte i domosdoshem qe te ruhet sistemi i drenazhimit dhe kjo gje do te coje ne evitimin e ndryshimeve jo shume te rendesishme te sistemit te ujrate siperafaqesore.

#### 4.10.3. *Ndikimet në regjimin e perdorimit te ujërave*

Realizimi i projektit te HEC GOJAN, do tē ndikojë në regjimin e ujrate sipërfaqesore tē perrenjeve, në prurjen e tyre, duke i marrë një pjesë në rrjedhjen e sipërme, që do t'i kthehet përsëri në sektorin e poshtëm. Uji që merret nuk pëson ndryshime kimike në vetit vjetitë fiziko-kimike, ndaj nuk sjell asnje problem në rrjedhjen e këtyre lumenjëve. Për tē sigruuar vazhdimësinë e vlerave ekologjike, duhet tē zbatohet Direktiva Kuadër e Ujit e BE-së (WFD-2000), që thekson që "cilësia ekologjike" e lumenjëve nuk duhet tē ndikohet negativisht nga çdo lloj modifikimi i bërë në trupat ujorë apo në shtratin humor".

Ujerat e shirave qe bien, duke u bashkuar dhe me ujerat siperafaqesore te degeve perberese te tjere me te vegjel, ushqejne rrjedhjen e Lumin Fan i Madh.

Ujerat siperafaqesore do te pesojne ndryshime sepse:

- Do te kete shhangje te perhereshme te nje sasie te ujit te lumit per HEC GOJAN dhe pastaj shkarkimi i tij ne HEC-in e me poshtem bejne qe gjatesia e munguar e ujit ne aksin e lumitte mungoje dukshem gjate fazes se operimit te HEC GOJAN mund te theksojme se, perveç prurjes ekologjike qe do te ruhet ne shtartin e lumit, nga aksi ku vepra e marrjes do te ndertohej deri tek centralit zhvillohen dege ujore ushqyese te lumit te cilat ruajne ekuilibrat ekologjike.
- Nuk do te kete ndikim domethenes ne ujerat nentokesore sepse nuk do te krijohen basene te medhenj ujore per rregullimin e regjimit te prurjeve.
- Nuk do te krijohen rreziqe te mundshme nga projekti per permbytjen per popullsine e zones sepse pervec prodhimit te energjise se paster elektrike do te disiplinoje edhe ujerat ne kete segment
- Nuk do tē ketë ndikim domethënës në ujerat nëntokësorë sepse nuk do tē krijohen basene tē medhenj ujorë për rregullimin e regjimit tē prurjeve.

- Përrenjtë nuk do të thahen dhe nuk do të krijohen probleme me shtratin e tij të vjetër, sepse do të përdoret vetem një pjesë e sasisë së prurjeve të tyre.
- Në periudhën e verës do të punohet me kapacitet jo të plotë.
- Lihet një prurje e konsiderueshme, e quajtur prurja ekologjike, të rrjedhë në shtratin natyror të përroit. Këtu përfshihet edhe kontributi i përrrenjve të tjerë më të vegjël pas veprave të marrjes të HEC-it.
- Nuk do te krijohen rreziqe të mundëshme nga projekti për përbimitje për popullsinë e zonës sepse përvëç prodhimit të energjisë së pastër elektrike do të disiplinojë edhe ujërat në segmentet e interesuar nga HEC-i.

#### 4.10.4. Ndkimi ne balancen e ekosistemit

Do te kete ndryshim te parametrave ekologjike si pasoje e marrjes se një sasie te ujit per t'u shfrytezuar nga vepra. Ndkimi do te jete me domethenes ne pjesen e lumbit ku do te ndertohet vepra e marrjes se HEC - it, ndersa ne pjeset e poshtme te tyre, parametrat do te kalojne ne gjendje me te ekuilibruar natyrore, sepse lumi ushqehet nga mjaft perrenj te tjere anesore me prurje te konsiderueshme qe e minimizojne ndikimin.

Bilanci biotik do te kete ndryshime te vogela ne segmentin e lumbit ku do ndertohen veprat e marrjes se HEC GOJAN, por ne rrjedhen e poshtme qe eshte edhe pjesa me dinamike ne lloje dhe numerike rivendoset gjendja normale si pasoje e shtimit te ujit nga affluentet e ketij lumi. Duke qene se shfrytezimi i ujerve nga vepra hidroenergitike ne periudha kritike do te jete i kufizuar, kjo ben te mundur ruajtjen e ekuilibrit ekologjik te basenit ujor.

Bazuar ne Ligjin Nr. 111/2012 Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, Neni 39 Përdorimi i burimeve ujore, pika 4, prurja Q<sub>355</sub> ditore sipas kurbes se qendrueshmerise se prurjes.

#### 4.10.5. Ndkimet e ndotësave dhe mbetjeve në cilësinë e ujit

Ndertimi dhe shfrytezimi i HEC GOJAN, jane aktivitete te cilat nuk shoqerohen me shkarkime te ndotësave apo me procese kimike perpunimi. Prodhimi i energjisë elektrike ben pjesë ne proceset me teknologji te paster, pra dhe cilesia e ujit i cili sherben si lende e pare ne keto procese nuk do te ndryshoje se nuk ka dhe nuk do te shkarkohen ndotesa jo vetem te ujit por as te tokes e te ajrit.

Ndërtimi dhe shfrytëzimi i hidrocentralit janë aktivitete që nuk shoqërohen me shkarkime të elementeve ndotës. Energjia elektrike do të prodhohet nga burim i pastër. Uji mbetet në parametrat e tij të zakonshëm

#### 4.10.6. Ndkimet në ajër

Aktiviteti i prodhimit të energjise elektrike nuk emeton asnjë lloj gazi në ajer, pra ky aktivitet nuk ka ndikim në cilësinë e ajrit. Gjatë proceseve të ndërtimi kjo ndotje nga makineritë është e përkohshme dhe e papërfillshme.

Gjate fazave te ndertimit te HEC GOJAN dhe germimeve mund te kete emetim pluhurash dhe ky ndikim negativ ne cilesine e ajrit do te jete i perkohshem. Gazet e demshme te cliruara nga djegia e karburantit te automjeteve dhe pluhurat mund te krijohen gjate fazes se ndertimit te HEC GOJAN por gjithnjë pa i kaluar limitet e lejuara, nderkohe qe gjate shfrytezimit te HEC-it nuk do te kete emetime gazesh te demshme dhe theksojme se keto burime gjenemese te energjise elektrike jane te pastra.

#### 4.10.7. Ndikimet ne klime

Nga aktiviteti nuk ka asnjë lloj shkarkimi që të ketë ndikime në elementet e klimës.

#### 4.10.8. Aromat shqetësuese

Ky aktivitet nuk emëton dhe nuk do të emëtojë gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit gaze, aroma apo shkarkime të tjera që prodhojnë aroma shqetësuese

#### 4.10.9. Ndikime të tjera në mjedis

Gjate ushtrimiit të aktivitetit nuk priten ndikime të tjera klimatike si ne drejtim të permirsimit ashtu dhe të perkeqsimit të saj.

Infrastruktura e projektuar per ndertimin e HEC-it si dhe linja e energjise elektrike per lidhjen me nenstacionin Jane projektuar ne perputhje me kushtet klimatike dhe mjesitore te zones. Do te kete nje lidhje sistemi te tille, e cila kerkon ndertimin e linjes se re te transmetimit, kjo per shkak te sasise se madhe te fluksit te energjise, e cila prodhohet dhe rrjeti aktual eshte i pamundshem per te perballuar kete sasi.

- Te gjitha ndertesat apo strukturat e vendosura ne lartesi duhet te pajisen me statike ne menyre qe te presin rrufete e rena ne kohe shtrengatash
- Mbrojtja mekanike ne vartesi nga instalimet dhe aplikimet e paisjeve elektrike, mbrojtja sipas klasave behet sipas standartit IEE 60529

#### 4.10.10. Ndikime të tjera indirekte dhe sekondare që shoqërojnë projektin

Projekte te tjera si p.sh rruget e reja, kanalet e ujrave te zeza, banesat, linjat e energjise, telekomunikacionit, etj nuk do te ndikojne ne realizimin e ketij projekti pasi ne zonen ku zbatohet ky projekt nuk ka elemente te infrastruktureve qe u permenden me lart.

Ndonjë rrrugë dytësore e re dhe e shkurtër, ujërat e zeza te godina e hidrocentralit etj nuk do të ndikojnë dukshëm në mjedis. Elemente që përmenden nuk janë në atë shkallë të pranishëm në këtë zone.

#### 4.10.11. Ndikimet shoqëruese të projektit me projekte egzistuese ose të propozuara

Ky projekt do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin e infrastrukturës rrugore te zones perrreth, në rrjetin elektrik shpërndarës për banorët dhe minierat e mundshme, në rritjen e nivelit social-ekonomik të banorëve.

Projekti nuk do te kete ndikim negativ ne infrastrukturen rrugore te zones ku do te ngrihen e te funksionojne HEC - i. Ndikim do te kete vetem gjate fazes se ndertimit per shkak te rritjes se fluksit te automjeteve.

Realizimi i ketij projekti se bashku me infrastrukturen rrugore qe po ndertohej behen elemente kyc ne infrastrukturen lokale.

Gjate fazes se shfrytezimit qarkullimi i automjeteve do te jete i kufizuar dhe nuk do te perbeje rrezik sinjifikativ per aksidente. Korridoret e hyrje-daljeve ne veper dhe rruget komunikues te objekteve behen ne vende te pershtashme e pa prishur breza pyjor te brigjeve te perrenjeve. Rikonstruksioni i qe do te behet nga kompania i rrugeve ekzistuese per ne objektet e HEC - it dhe ato ekzistuese do te mirembahen ne nevoje te vepres dhe te komunitetit te zones.

### 4.11. Mbetjet e ngurta

Gjate aktivitetit per realizimin e projektit do te kete krijim volumesh te materialit te ngurte te gerrnuar por jo te demshme. Guret qe do te dalin nga germimet per linjat e derivacionit me tubacion ne te gjithe gjatesine e tij do te riciklohen per ndertimin e mureve, te baseneve te presionit, godinat e HEC - it, rruget, pasi si material i ngurte kryesisht do perdoret materiali vendas etj.

Plani i vendgrumbullimit dhe rehabilitimit perfshin zonat ku do te realizohen punime depozituese dhe rehabilituese, si dhe volumin dhe llojin e punimeve. Hidrocentrali do te zhvillohet ne harmoni me vlerat e natyres. Brigjet dhe shpatet e maleve ne zone perbejne habitate poteneiale per biodiversitetin qe mbartin. Ndertimi i veprave hidroteknike kerkon realizimin e shume punimeve dhe ndertimin e disa veprave (prita, kanali i manjes se ujit, shtrim tubacionesh, ndertim plintash, ndertim godine te turbinave etj).

Vemendje kryesore gjate ketyre punimeve duhet te tregohet ne dy aspekte sistemimi i dherave te krijuar nga keto punime, sistemimi i brigjeve dhe shpateve per te evituar fillimin e erozionit. Studimi i hollesishem e strukturave gjeologjike, qendrueshmerise se tyre dhe masave te propozuar nga projektuesit e ketyre hidroeentralit jane garanci qe keto probleme mjedisore do te jene minimale. Pra, mund te themi se nga ky aktivitet nuk pritet te kete ndikim mjedisor te matshem pasi:

- Nuk ka prodhim te mbetjeve te rrezikshme.
- Nuk shkakton ndotje te tokes me shkarkirne te ndryshme te lengeta apo te ngurta.

- Nuk ka shkarkime ne ajer te gazrave apo tymrave.
- Zhurrat ne mjediset e punes do te jene brenda normes shendetesore te lejuar, dhe per pasoje as zhurrat ne mjediset e jashtme nuk pritet te kene ndikim ne popullaten perreth.
- Nuk ka clirim te aromave te ndryshme etj

Per kete aktivitet eshte e nevojshme qe te kete bashkepunim me autoritetet vendore dhe grupet e interesit, per ruajtjen e parametrave hidroenergjiteke pa prishur ekuiliberat mjedisore dhe ato te nevojave te popullates per nevoja te ndryshme. Pas ndertimit te nenveprave duhet te mbahet nen mbikqyrje rehabiliti i zonave te prekura nga punimet, i cili duhet te filloje menjhere mbas perfundimit te punimeve te HEC-it.

#### **4.12. Ndertimi i linjes se transmetimit te energjise**

Nenstracioni elektrik ngrites 6/110 KV eshte vendosur ne aferi te nderteses, rreth 20 m larg saj. Lidhja me sistemin energjetike behet direkt nga nenstacioni mbasi linja kalon ne afersi te nderteses se centralit rreth 50 ml larg saj.

#### **4.13. Heqja nga fondi Pyjor dhe marrja ne perdom e fondit pyjor**

Nga zbatimi i ketij projekti per ndertimin e HEC GOJAN, do te preket fondi pyjor e kulloso. Nga vleresimi paraprak i bere, rreth 0.5 ha do duhet te hiqet nga fondi pyjor, dhe rreth 0.5 ha do te merret ne perdomim nga Fondi Pyjor.

Me me detaje kjo siperfaqe do te percaktohet kur te procedohet per marrijen ne perdomim dhe heqjen nga fondi pyjor te siperfaqeve qe do te zene veprat e HEC HEC GOJAN. Bashkelidhur harta e ekonomise Pyjore.

Mbeshtetur ne legjislacionin e ri, dhe ndyshimet qe kane ndodhur ne sektorin e pyjeve dhe mbeshtetur ne udhezimin e Ministrit te Mjedisit Nr.01, date 09.06.2016, procedura per marrjen ne perdomim do te zhvillohet prane Bashkise Puke, ndersa procedura per Heqjen nga fondi pyjor do te zhvillohet prane Ministrise se Turizimit dhe Mjedisit.

## V. PERSHKRIM PER SHKARKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

### 5.1. Pershkrim i pergjithshem

Në kontekstin e këtij shënim i udhëzues, termi "hidrocentral" mbulon një larmi të madhe të skemave ose projekteve të energjisë, duke përfshirë skemat e fushave te medha te ndetimit dhe rehabilitimin ose modifikimin e skemave ekzistuese.

Skemat hidroenergitike përgjithësisht klasifikohen si skema magazinimi te ujit ose skema të rrjedhjes së lumbit. Skemat e magazinimit te ujit në mënyrë tipike përbëhen nga një digë që mban ujë, ngrë nivelin e saj dhe krijon një rezervuar artificial ("zona e mbylljes") që mund të përdoret për të ndryshuar rrjedhën e lumenjve në rrjedhën e sipërme nepërmjet rregullimit.

Rezervuari dhe diga shpesh përbëjnë një pengesë të rëndësishme përvazhdimësinë e një ekosistemi lumor dhe funksionet e tij, duke përfshirë kalimin e sedimenteve, migrimin e peshqve dhe përdorimin e lumbit. Uji nga rezervuari ose mund të futet direkt ne turbina te vendosura në bazën ose në pjesën e përparme të digës ose mund të devijohet me kanal derivacioni ose tunel ne në një central elektrik të vendosur më poshtë në drejtim të rrymës para se të shkarkohet përsëri në shtratin e lumbit.

Në anën tjeter, skemat me rrjedhje te ujit te lumenjve në mënyrë tipike mbështeten në strukturat më të vogla ndertimi, në vend të skemave të ruajtjes dhe nuk kanë ose vetëm një kapacitet të kufizuar magazinimi: ato përbëhen nga një veper marrje që mbledh dhe kalon ujë nepërmjet kanaleve ose tubave të turbinës) në central elektrik. Pavarësisht nga mungesa e digës apo pengese, devijimi i ujit ne keto skema mund të rezultojë në një fragmentim të konsiderueshmët të ekosistemave ujore (shtrirjes së lumenjve) dhe ekosistemave tokësore (ndërtimi i strukturave mbi tokë si kanalet dhe godina e HEC-it).

Skemat hidroenergitike gjithashtu mund të ndahan në ne varesi te fuqise se instaluar dhe kompleksitetit të infrastrukturës, duke përfshirë:

- HEC-et e vegjel
- Hidrocentralet kaskade,
- skemat komplekse që përfshijnë një shumëlojshmëri të rezervuarëve të magazinimit të ndërlidhur dhe impianteve prodhuese

Energjia e prodhuar nga një skemë hidroenergetike është proporcionale me (i) kohën ("faktori i përdorimit"), (ii) sasine e ujit ne turbina dhe (iii) ndryshimin në lartësi midis ujrale të rrjedhës së sipërme dhe ujtit të rrjedhës së poshtem. Hidrocentralet mund të përdoren për ngarkesë bazë ose gjenerimin e energjisë së pikut, por përdoren gjithnjë e më shumë për të balancuar furnizimin me energji dhe kërkesën. Funksionimi i skemave të hidrocentralit mund të jetë subjekt i ndryshimeve të shpejta operacionale të cilat mund të përkthehen në një numër të ndikimeve ose reziqeve ndaj njerëzve dhe ekosistemave si rezultat i rrjedhjes së shkaktuar artificialisht dhe ndyshimit te nivelit.

## 5.2. Aspektet mjedisore gjate periudhes se ndertimit

Problemi kryesor i lidhur me projektin e ndertimit te hidrocentraleve jane nderhyrjet dhe zhvendosjet fizike te tokes te cilat perfshijnë germimet ne sasi te madhe te dherabe dhe shkembit dhe disa raste edhe hapje e tuneleve dhe kanaleve te derivacionit. Ne rastin e ndertimit te HEC GOJAN, kemi te gjitha keto vepra te permendura me lart, pa kemi edhe hapje kanali pa presion edhe hapje tunelesh dhe germime per vendosjen e veprave te tjera si Baseni i Presonit, veprat e marrjes, Godina e HEC-it.

Aktivitetet e ndërtimit shpesh përfshijnë ndërtimin e kampeve të punëtorëve të përkohshëm, si dhe rrugët e përkohshme dhe të përhershme të qasjes në vend. Aspekte më specifike mjedisore që lidhen me aktivitetet e ndërtimit të veprave të hidrocentralit mund të përfshijnë:

- Pluhuri: për shkak të lëvizjes së tokës dhe aktiviteteve të nxjerrjes së materialeve të ndërtimit, si dhe lëvizjes së automjeteve ndërtimore në rrugët e pashtuara të hyrjes;
- Zhurma dhe vibrimet: të lidhura kryesisht me aktivitetet e nxjerrjes së materialeve, gërmimet, prishjet, materialet dërrmuese, grumbullimi dhe transporti tranzit i automjeteve;
- Mbeturinat e ngurta: në vëllim, kryesisht të lidhura me mbeturinat e shkëmbinjve dhe largimin e shtresës së siperme te tokes, por edhe mbeturinat e ndërtimit, si dhe mbetjet shtëpiake nga kampet e punës;
- Shkarkimet e ujërave të zeza: burimet mund të përfshijnë rrjedhjen e ujërave të shiut nga zonat e punimit, të cilat zakonisht shume presence sedimentesh ne gjendje pezull dhe rrjedhjet nga instalimet e operimit te kampeve të punëtorëve;
- Shkarkimet nga hapja e tuneleve: punimet e hapjes se tuneleve kriojnë rrjedhje që zakonisht shoqerohen me sasi te madhe te sedimentet pezull dhe mund të kenë pH shumë të ndryshme nga marrja e trupave ujorë sipërfaqësorë (për shembull, shkarkimet e tuneleve mund të janë një nje mjedis bazik i forte, për shkak të tokave alkaline ose përdorimit të cimentos standarde ose betoneve ne aktivitet e veshjes apo injektimit të tunelit; ose mjedis i fort acid, për shkak të pranisë së shkëmbit gjenerues të acidit, i quajtur Acid Rock Drenazhimi ose ARD). Futja e grimcave te cimentos nga laçi cimento dhe spruce betoni përdorur për të veshur muret e tuneleve mund të rezultojë në pH jashtëzakonisht të lartë në rrjedhën e tunelit dhe marrjen e trupit të ujit. Masat e rekomanduara për të zbutur ndikimet e shkaktuara nga qe dalin nga shpimi i tuneleve përfshijnë:
  - Hapja e tuneleve te behet ne Kohen te percaktuar te vitit per te parandaluar migrimin e peshqeve ose ate te leshimit te vezeve;

- Perdoni dhe mirembani te pellgjeve te sedimentimit per te kontrolluar sedimentet qe vijne nga tuneli dhe nga aktivitete e menaxhimit te çimentos, dhe per te future zbutjen automatike me solucioni kur kerkohet.
- Monitoroni nga afer pH dhe grimcat pezull ne suspension, te shkrakimeve te ujrate te tunelit, si dhe ne trupin ujor marres 100 ne pjesen e siperme te rrjedhjes dhe 100 m poshte pikes se shkarkimit, dhe te kete masa te qarta per te ndaluar shkarkimet e tunelit nese treguesit e shkrakimeve jane mbi ato te lejuar dhe specifikuar;

Me poshte ne menyre te permblehdhur ndikimet kryesore gjate fazes se ndertimit.

- a) Çlirimi i pluhurave gjate punimeve te germimit
- b) Gjate kohes se kryerjes se ndertimit do te kete zhurma te cilat shkaktohen si rezultat i perdorimit te makinerive te renda dhe qe do te vazhdojne deri ne momentin e perfundimit te punimeve.
- c) Prania e grumbujve me dhe ne mjedisin e zones prish imazhin e zones perreth.
- d) Ne nivelin e ujerat nentokesor gjate germimit te tokes per hapjen e themeleve, etj.
- e) Prishja e imazhit te zones gjate periudhes se ndertimit nga prania e mjeteve te tonazhit te rende, si hapja e gropave e shume te tjera.
- f) Konsumimi i energjisë elektrike.
- g) Kosumimi i materialeve te ndertimit dhe i burimeve te tjera te nevojshme per ndertimin e ketij objekti.

### 5.3. Gjenerimi i mbetjeve gjate fazes se ndertimit

Gjate aktivitetit per realizimin e projektit te ndertimit te HEC GOJAN do te kete krijim te materialit te ngurte inret te germuar. Keto materiali nuk jane te demshme sepse jane natyrale nga vendi ku punohite. Guret qe do te dalin nga germimet per linjat e nenobjekteve ne te gjithe gjatesine e tyre do te riciklohen per ndertimin e mureve dhe te gabioneve ne pjesë te ndyshme te nenobjekteve te HEC GOJAN.

Sipas llogaritjeve te bere ne Preventivin e projektit pritet ne total te gjenerohen 169,000 m<sup>3</sup> mbetje inerte te cilat do te perdoren per mbushje ngjeshje me materialin vendi.

Menaxhimi i mbetjeve inerte te gala nga gerimet dhe skarifikimet per ndertimin e veprave te HEC GOJAN do te behet ne perputhje me kerkesat e ligjit Nr.10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndyshuar dhe VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"

Materialet të cilat janë të ripërdorshme, mund t'ju jepen individëve të interesuar për punime ndërtimi në zonat periferike ose rehabilitim të lulishteve ose mbushje të

tokave aty ku ka nevoje, pjesa e mbetjeve të pa përdorshme duhet të grumbullohen në vendin e caktuar nga Njësia e Qeverisjes Vendore (NJ.Q.V) pas zbardhjes së Lejes së Zhvillimit nga Autoritetet Përgjegjëse. Këto mbetje duhet të menaxhohen në bashkëpunim me Njësinë e Qeverisjes Vendore dhe firmën pastruese të territorit dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte". Grumbullimi i mbetjeve duhet të jetë i diferencuar që në vendburim. Mbjetet inerte, apo edhe dheu i gërmuar, materiale të ndërtimit duhet të trajtohen në mënyre të veçantë. Në ketë fazë nuk kemi informacion për mënyren e menaxhimit të mbetjeve inerte, por pas zbardhjes së Lejes Zhvillimore është detyrim i Njësisë së Qeverisjes Vendoreë percaktimi i një vendi të tillë për depozitim e tyre. Landfilli ku do të depozitojen këto mbetje duhet që të jetë i pajisur me leje mjedisore dhe i miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak

Prodhimi i mbetjeve pritet të ketë ndikimin më të rëndësishëm mjedisor. Punimet e parashikuara në kuadrin e projektit do të prohjojnë disa lloje mbetjesh. Ato janë klasifikuar sipas katalogut evropian të mbetjeve dhe listës së mbetjeve të rezikshme meqënëse Republika e Shqipërisë po përafron legjislacionin me atë të BE-së. në këtë kapitull janë paraqitur vetëm emri i grupeve të mbetjeve, të shënuar me numra sin ë katalogun evropian të mbetjeve. Në secilin grup, llojet e mbetjeve mund të shënohen me yll (\*) i cili përfaqëson mbetjet e rezikshme. Nën-grupi i saktë i mbetjeve me numrin e tij identifikues do të identifikohet në vendndodhje.

Llojet e grupeve kryesore të mbetjeve që mund të priten në zonë mund të jenë si më poshtë por nuk përashtohen mbetje të tjera:

- 17 Mbjetet e ndërtimit dhe shembjeve (përfshirë dheun e gërmuar nga vendet e ndotura);**
- 20 Mbjetet bashkiake (mbetjet e familjeve, dhe mbetje të ngjashme tregtare, industriale dhe institucionale) përfshirë copat e mbledhura veçmas.**

Referuar Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve miratuar me VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve"

- |          |   |
|----------|---|
| 17 03    | Përzierje bituminoze, bitumi dhe produkte të tjera të ziftit  |
| 17 03 02 | Përzierje bituminoze, të tjera nga ato të përmendura në 17 03 01  |
| 17 05    | Dhera (duke përfshirë dhera të gërmuara nga toka të kontaminuara, gurë dhe balta të tjera)                          |
| 17 05 04 | Dhera dhe gurë, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 03  |
| 17 05 06 | Balta, të tjera nga ato të përmendura në 17 05 05   |
| 17 09    | Mbetje të tjera ndërtimi dhe të prishjeve   |
| 17 09 04 | Mbetje të përziera nga ndërtimi dhe të prishjeve, të tjera nga ato të përmendura në 17 09 01, 17 09 02 dhe 17 09 03 |

Mbeshtetur ne VKM Nr.575, date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"

- Krijuesi dhe zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të plotësojnë dhe të nënshkruajnë dokumentin e transferimit të këtyre mbetjeve dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rezikshme"
- Subjekti, që prodhon mbetje inerte gjatë ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes së objektit, është përgjegjës për dëmet e drejtëpërdrejta ndaj palëve të treta që dëmtohen nga ushtrimi i aktivitetit të tyre dhe nga detyrimet kontraktuale.
- Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në lendfile dhe venddepozitimet e përkohshme, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë. NJQV-të duhet, që, brenda muajit janar të çdo viti, të dërgojnë te ministria që mbulon infrastrukturën publike të dhënat vjetore për mbetjet e trajtuara në lendfile dhe venddepozitime të përkohshme të mbetjeve inerte.

Per transportin e mbetjeve inerte, referuar Ligjit Nr.10463, date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", subjekti do te kontrakoje një operator te licensuar me licence te tipit III.2.B. Gjithashtu, ne lidhje me depozitimin e mbetjeve do te mbahet korrespondence dhe do te merret miratim nga Bashkia Puke per venddepozitimin e mbetjeve inerte.

Nese gjate aktivitetit te ndertimit kryhen procese pune qe shkakojne mbetje te rezikshme, kontraktori duhet të ndjekë procedurën e ndarjes së mbetjeve të rezikshme në vend. Kontraktori duhet t'i dorëzojë mbetjet tek kompania e autorizuar për administrimin e mbetjeve të rezikshme dhe të plotësojë dokumentacionin shoqëruesh i cili duhet të mbahet si provë e praktikës së mirë në administrimin e mbetjeve.

Është shumë e rekomandueshme të ndahen llojet e ndryshme të mbetjeve (ambalazhet plastike dhe të qelqit), për të cilat ekzistojnë sisteme të veçanta grumbullimi/riciklimi në vend, nga ato mbetje që janë të pariciklueshme dhe të dërgohen në pikat e përshtatshme të grumbullimit së bashku me dokumentacionin shoqëruesh.

Mbetjet e pariciklueshme duhet të dërgohen në një landfill të miratuar. Sheshi i ndërtimit do të pastrohet dhe të gjithë hedhurinat dhe materialet e mbetjeve do të eliminohen në përputhje me klauzolat e specifikuara në preventivat. Djegia apo hedhja e paligjshme e mbeturinave është rreptësisht e ndaluar. Mbetjet bashkiake dhe mbetjet e tjera do të duhet të mblidhen në kontejnerë të veçantë për këtë qëllim dhe të largohen rregullisht.

Dheu i gërmuar nga sheshi, duhet të hiqet dhe të depozitohet në një vend i cili duhet te jetë i miratuar nga autoritetet lokale.


Administrimi i mbetjeve gjate fazes se ndertimit duhet te behet ne perputhje me kerkesat dhe rregullat e vendlorur autoritetet lokale. Te synohet riperdorimi i mbetjeve te ngurta, por edhe kur kjo nuk eshte e mundur depozitimi i tyre te behet me leje te institucioneve perkatese dhe ne vendin e caktuar per kete qellim.

#### 5.4. Ujra te ndotur nga aktiviteti human

Zona nuk ka fasilitete te trajtimit te ujerave te ndotur apo heqjes se mbetjeve te ngurta. Ujrat e ndotur te fshatrave qe ndodhen prane, i derdhin ato ne trupin ujor me te afert, gje e cila bie ndesh me parametrat e cilesise se ujerave te embel dhe per trajtimin e ujerave me qellim ruajtjen e tokes dhe ujerave siperfaqesore dhe nentokesore nga ndotja. Gjer në kohën e ndërtimit të rrjetit të jashtëm të kanalizimit, ujërat e ndotur të dala nga objekte të veçuara apo zona të tëra të qendrave të banuara (në rastin tone të godinës së centralit) mund të mblidhen në gropë septike, nga të cilat, në kohë të caktuara largohen me mjete të ndryshme transporti (autobote etj) të autoritetit përkatës Ujësjellës Kanalizimeeve. E njejtë zgjidhje do te behet edhe ne kete rast.

##### 5.4.1. Gropë septike

Në këto gropë lëndët organike që përmbajnë ujërat e zëza kanë aftësi të dekantojnë lehtë meqëshpejtësia e rrjedhjes së këtyre ujrave prodhon gaze me erë të rëndë dhe zvogëlon vëllimin e tij.



Kështu një gropë septike përfaqëson një farë dekantuesi të myllur, tek i cili bëhet dekantimi i ujrave të ndotur dhe kalbëzimi i llumit të dekantuar. Gropat septike mund të kenë një, dy ose tri ndarje nëpër të cilat ujërat e ndotur kalojnë nga e para në të dytën e kështu me radhë. Në seksionin e parë, dekantimi është më i madh, prandaj edhe përmasat e tij merren më të mëdha se të seksioneve të tjera. Lumi, sidomos në të ndarën e parë, ngjeshet mirë dhe zvogëlon vëllimin 3-4 herë.

Skema të gropave septike me tri ndarje (seksion rrëthor dhe drejtkëndësh). Lëndët në gjendje pezull notojnë në sipërfaqe dhe aty duke u tharë e duke u ngjeshur formojnë një farë cipe. Në mënyrë që ujërat e ndotur të hyjnë normalisht në gropë e të dalin prej saj pa u penguar nga kjo cipë e krijuar, tubat e hyrjes dhe të daljes, si dhe vrimat ndërmjet ndarjeve të gropës pajisen me tridegësh (pjesë T). Vrimat e lëna në muret ndarëse kanë përmasa (15x15) cm.

Gjate fazes se ndertimit, për nevoja të punetoreve dhe stafit teknik, ne kantjeret ku punohet do te instalohen kabina portative te banjove publike, ne menyre qe te shmangen shkarkimet ne mjedis. Shkarkimet e tyre do te lidhen me gropen septike. Gropa septike, mund te sherbeje edhe gjate fazes se funksionimit



## 5.5. Mbetje te rrezikshme

Mbetje të rrezikshme jane mbetjet: "eksplozive", substancat dhe preparatet të cilat mund të shpërthejnë nën efektin e flakës ose të cilat janë më të ndjeshme nga goditja apo fërkimi dhe "oksiduese", substancat dhe preparatet të cilat kanë reaksione të fuqishme ekzotermioke kur bien në kontakt me substanca të tjera, veçanërisht me substanca të djegshme. "shumë të djegshme": mbetje vajrash dhe mbetje te karburanteve te lëngshme, te rrezikshme": substancat dhe preparatet, të cilat nëse thithen nëpërmjet frysma marrjes, injektohen ose penetrojnë në lëkurë mund të shkaktojnë rrezik të kufizuar të shëndetit.

### 5.5.1. Gomat e perdorura

VKM nr. 652, datë 14.9.2016, "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura" nenkupton menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura, rregullat dhe kriteret që përfshijnë mbledhjen/grumbullimin, transportimin, ruajtjen/ magazinimin dhe trajtimin e gomave të përdorura në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit. Në kuptim të këtij vendimi me termat e mëposhtëm nënkuption: "Grumbullues" personi që kryen grumbullimin e mbetjeve të gomave të përdorura. "Magazinues", personi që kryen ruajtjen e përkohshme të mbetjeve. "Trajtues", personi që kryen trajtimin e mbetjeve. Gjate ndertimit te hec-it, gomat jashtë perdorimit nuk do te digjen apo te hidhen por do te grumbullohen dhe transportohen nga shoqeria investitore dhe do te magazinojen ne ambiente te caktuara (shoqeri te licensuara per grumbullimin e tyre) dhe do te trajtohen si goma të përdorura në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e

mjedisit perreth ku ndertohet hec-i. I gjithe procesi i grumbullimit, transportimit dhe magazinimit do te behet sipas rregullave dhe procedurave te shoqerise se licensuar per grumbullimin e tyre.

#### 5.5.2. Lubrifikantet dhe karburantet

Perdorimi i lubrifikanteve do te jete i kushtezuar per shkak te perdorimit te makinerive te germimit dhe transportit.

Ndikimet e mundshme vijnë nga të gjithë llojet e automjeteve gjatë ngarkimit dhe shkarkimit, gazet e shkarkimeve nga makineritë e punës, trafiku i automjeteve dhe shkarkimet e automjeteve në përreth.

Të gjitha automjetet do të mirëmbahen si duhet dhe do të testohen për të minimizuar shkarkimin në ajër.

Të gjithë motorët me djegie të brendshme do t'ju bëhet servis dhe do të mirëmbahen në mënyrë të përshtatshme për të reduktuar emetimet e ndotësve në një nivel të pranueshëm. Aty ku do të jetë e mundur motorët do të vendosen larg zonave të punës

Të zbatojë rigorozisht standardet kombëtare të emetimeve për automjetet dhe të forcojë menaxhimin e automjeteve të zbatimit të ligjit, ndalohet emetimi i tepërt i ndotësve të shkarkimeve automjeteve motorike, në mënyrë që të reduktohet emetimi i shkarkimeve.

Të zbatojë rigorozisht standardet kombëtare të emetimeve për automjetet dhe të forcojë menaxhimin e automjeteve për zbatimin e ligjit.

Në formën e shkarkimeve të paristrukturuara, për të siguruar që punonjësi të punojë nën një mjedis të mirë prodhimi, për të siguruar që centrali i ventilimit të jetë në gjendje të mirë, do të instalohen ventilator, për të zgjedhur përqendrimin në ambientin e punës.

#### Ruajtja e karburantit, naftës dhe substancave tokiske të rrezikshme

- Të gjitha vendet e ndërtimit të magazinimit të karburantit duhet të janë të rrethuara;
- Depozita sekondare (për karburantet, vajin, substancat e rrezikshme) duhet të ketë 110% të kapaciteteve te depozites se karburantit. Hapësira e magazinimit të karburantit nuk duhet të jetë pranë ndonjë burimi të ujët (domethënë: nga uji brenda 100 metrave);
- Materialet e rrezikshme duhet të ruhen përkohësisht në pajisjen e ruajtjes të specifikuar dhe të përdorshme vetëm për punonjësit e trajnuar dhe të autorizuar.
- Të tillë si lëndë djegëse, nafte dhe sende të tjera të rrezikshme gjithashtu kërkojnë depozita të përkohshme.
- Hyrja në zonën e magazinimit është e kufizuar vetëm tek personat e autorizuar;
- Depozita e karburantit në automjet duhet të ruhet nga demtimet dhe të kontrollohet rregullisht përrnjehje, dëmtime dhe ndotje;

- Mirëmbajtja e makinerive dhe pajisjeve është e kufizuar për të bëhet brenda zonës së kantjerit të kontraktorit me dysheme të padepërtueshme dhe sistemin e grumbullimit dhe trajtimit të ujit ose në serviset e automjeteve.
- Sipërfaqja e operimit (dmth. brenda zonës së rrethuar të dyshemesë së betonit) duhet të jetë e projektuar siç duhet për të siguruar që vaji dhe karburantet e tjera mund të përqendrohen në një enë të përshtatshme. Në rast të rrjedhjeve të naftës / lëndëve djegëse, largimi i tokës së kontaminuar kërkohet për vende të licencuara siç duhet përpunim;
- Për të parandaluar yndyrat, vajrat, lëndët djegëse, tretësit dhe kimikatet për erozionin e ujit dhe tokës të shkaktuara nga ndotja ose gjithmonë duhet të miratojnë masat parandaluese përkatëse

Burimet e ndotjes se tokes:

Siperfaqja e tokes:

- Shtresa e sipërme e tokës do të hiqet dhe do të ruhet në një zonë të dedikuar. Procedura e Menaxhimit të Kontrollit të Erozionit dhe Sedimentit si pjesë e PMMS do të zhvillohet nga kompania
- Ruajtja ose asgjësimi i parregullt i mbeturinave: Çdo magazinim i përkohshëm i mbeturinave përbën një rrezik ndotjeje për token.

#### 5.5.3. Derdhjet

Probabiliteti i derdhjeve të shkallës së vogël (më pak se 20 litra) dhe të mesme (ndërmjet 20 dhe 100 litra) është më e madhe gjatë operacioneve të furnizimit me karburant.

Kontraktuesi do të sigurojë që vetëm stafi i trajnuar dhe me përvojë do të merret me kryerjen e operacioneve të furnizimit me karburant.

Ngarkimi i karburantit do të bëhet gjithmonë duke përdorur pajisje korakte, domethënë hinkë të madhësisë dhe gypave të duhur.

Të gjithë furnizuesit e karburantit të palëvizshëm do të kenë mbledhëse pikash.

Të gjitha kimikatet dhe lubrifikantët do të ruhen siç duhet për të shmangur rrjedhjet në tokë.

Në rast të derdhjes në tokë, do të merren veprimet e duhura.

Magazinimi i përkohshëm i substancave dhe mbeturinave të rrezikshme, nëse përdoret, duhet të ketë dysheme të papërshkueshme (p.sh. beton).

- a) Derdhje te vogla (më pak se 20 litra)
  - Ndaloni rrjedhjen
  - Përdorni materiale absorbuese për të pastruar derdhjen.
  - Mbledhja e materialit absorbues të kontaminuar në thasë plastike të etiketuar dhe vendosur në kontejnerë të përshtatshëm, që duhet të merren dhe pastaj të transportohen, përpunohen më tej / depozitonë si mbeturina të rrezikshme do të bëhet vetëm nga një subjekt i licencuar.
  - Vendosni konteinerët në vendin e caktuar.

- Rehabilitoni zonën e kontaminuar në gjendjen e saj të mëparshme.
  - Hartoni një raport të incidentit pas procedurës standarde të njoftimit të incidentit dhe raportoni tek Konsulenti monitorues dhe Punëdhënësi.
- b) Derdhje e mesme (midis 20 dhe 00 litra).
- Ndalon rrjedhjen
  - Kufizoni përhapjen e derdhjes duke përdorur thasë rëre sipas nevojës.
  - Gërmaje tokën deri në në fund të derdhjes për të parandaluar ndotjen e ujërave nëntokësore. Vendosni material absorbues në kanal.
  - Mbledhja e materialit absorbues të kontaminuar në thasë plastike të etiketuar dhe vendosur në kontejnerë të përshtatshëm, që duhet të merren dhe pastaj të transportohen, përpunohen më tej / depozitohen si mbeturina të rezikshme do të bëhet vetëm nga një subjekt i licencuar.
  - Rehabilitoni zonën e kontaminuar dhe kthejeni atë në gjendjen e saj të mëparshme. Hartoni një raport të incidentit pas procedurës standarde të njoftimit të incidentit dhe raportoni tek Specialisti i Mjedisit.
- c) Derdhje ne shkallë të madhe (më shumë se 100 litra)
- Ndalni rrjedhjen.
  - Kufizoni përhapjen e derdhjes duke përdorur thasë rëre sipas nevojës.
  - Gërmaje tokën deri në në fund të derdhjes për të parandaluar ndotjen e ujërave nëntokësore. Vendosni material absorbues në kanal.
  - Mbledhja e materialit absorbues të kontaminuar në thasë plastike të etiketuar dhe vendosur në kontejnerë të përshtatshëm, që duhet të merren dhe pastaj të transportohen, përpunohen më tej / depozitohen si mbeturina të rezikshme do të bëhet vetëm nga një subjekt i licencuar.
  - Rehabilitoni zonën e kontaminuar dhe kthejeni atë në gjendjen e saj të mëparshme. Hartoni një raport të incidentit pas procedurës standarde të njoftimit të incidentit.
  - Procedura e parandalimit dhe përgjigjes në rast derdhje është pjesë e planit te menaxhimit te mjedisit të zhvilluar nga Kompania

## VI. INFORMACION PER KOHEZGJATJEN E MUNDSHME TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE IDENTIFIKUARA

### 6.1. Metodat e vleresimit

Shumë metoda janë futur gjatë 50 viteve të fundit për të plotësuar kërkesat e ndryshme të studimeve të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ekziston një nevojë për një qasje të përgjithshme dhe tërësore për të justifikuar, shpjeguar, demonstruar, zbatuar, marrjen e mostrave, duke përdorur dhe duke krijuar aftësi reale në analizë në çdo fushë të shoqërisë njerëzore. Shumica e vendimeve të menaxhimit kanë të bëjnë me të ardhmen; megjithatë, e ardhmja është zakonisht e pasigurtë. Përdorimet e identifikimit, analizës dhe vlerësimit të rezikut në lidhje me mjedisin janë zgjeruar gjërisht në vitet e fundit.

Udhëzimet e Komisionit European ofrojnë informacion mbi qasjet që janë përzgjedhur nga studimet e rasteve dhe studimi i literaturës. Këto përfshijnë teknikat e përcaktimit dhe të skanimit që parashikojnë madhësinë dhe rëndësinë e ndikimeve dhe përpjekjet për t'i përcaktuar ato në bazë të intensitetit, frekuencës, kohëzgjatjes dhe karakterit të tyre.

Metodat e vlerësimit dhe shqyrtimit përfshijnë:

- modelimin
- Metodat krahasuese

Teknikat perfshijne:

- Matricat
- Opinion i ekspertit

Procesi i VNM perfshire një kombinim te qasjeve:

- Identifikimi dhe percaktimi i ndikimeve
- Analizimi i ndikimeve
- Percaktimi i rendesise se ndikimit

Matrica e ndikimit është përdorur për vlerësimin e ndikimit në mjedis të hidrocentraleve të vegjël dhe paraqet një pasqyrë, shpërndarje dhe klasifikim të ndikimit të projekteve në mjedis me kritere të ndryshme për qëllime të vlerësimit.

Përveç kësaj, gjithashtu thekson identifikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritura të projektit në mjedis. Matrica e paraqitur e ndikimit kombinon metodat cilësore dhe sasiore: deklaratat verbale të cilat u transformuan në vlerat numerike të paraqitura në Tabelën.

Ky vlerësim kërkon vëmendje të veçantë dhe punë të ndjeshme me shkallë verbale dhe numerike. Përdorën vlerat e indikatorëve. Kjo metodë përbëhet nga vetëm një metodë shumë e përafërt, ku me vlerën e saj një tregues mund të përfaqësojë një përshkrim të problemit të analizuar.

Metodologjia e propozuar e VNM përfshin një kombinim të qasjeve:

- Vendosja e kontekstit
  - Karakteristikat e gjendjes aktuale të mjedisit në zonën e prekur
  - Përshkrim i shkurtër i alternativave të veprimtarisë së propozuar
- Pershkimi i ndikimeve
  - Karakteri i ndikimeve
  - Rendesia e ndikimeve
  - Kohezgjatja e ndikimeve
- Percaktimi i shkalles se ndikimit dhe
- Krahasimi i alternativave

#### **6.1. Faktoret dhe kriteret qe zbatohen ne vleresimin e kohezagjatjes se ndikimeve te mundshme**

Për të përcaktuar nëse një ndikim negativ në mjedis, gjatë zbatimit dhe funksionimit të projektit, duhet të reduktohet apo të zbutet, do të bazohet në një ose më shumë nga faktorët e mëposhtëm:

- Krahasimi me ligjet, rregulloret apo me standartet e pranuara (kombëtare dhe udhëzimet dhe standartet ndërkombëtare)
- Konsultimi me vendimmarrësit përkatës dhe me agjencitë e mjedisit, etj.
- Preferencë të kritereve të paravendosura, si zonat e mbrojtura apo zona me ndjeshmëri të lartë mjedisore
- Përputhshmëria me objektivat e politikave qeveritar
- Pranueshmëria e zbatimit të programit nga komuniteti lokal dhe nga banorët e zonës kudo të zbatohet projekti.
- Mbledhja e sa më shumë informacioneve dhe njojurive lidhur me temën e projektit, nivelsa më i lartë dhe një gjykim sa më të mirë profesional të ekipit të që harton vlerësiminmjedisor
- Njohje dhe vlerësim më të mirë të vlerave të ekosistemit.

Ky kapitull përfshin krahasimin e alternativave të aktivitetit të propozuar (HEC GOJAN) dhe zgjedhjen e alternativës optimale, duke përfshirë një krahasim me zero alternativa.

Hapi i parë i vlerësimit të ndikimit të aktivitetit të propozuar në mjedis është identifikimi i ndikimeve mbi komponentët e pjesshëm të mjedisit. Gjatë zhvillimit të kritereve dhe përcaktimit të rëndësisë së tyre, vendosëm theksin në natyrën,

shtrirjen dhe kohëzgjatjen e efekteve. Kemi përcaktuar vlerat ndaj pasojave individuale sipas shkallës së propozuar:

- Karakteri i ndikimeve (KN)
  - - ndikime negative
  - 0 pa ndikim (neutral)
  - + ndikim pozitiv
- Rendesia e ndikimeve (RN)
  - 1 i parendeshishem
  - 2 i rendeshishem
  - 3 shume i rendeshishem
- Kohezgjatja e ndikimeve
  - 0.5 afatshkurter
  - 1 afatgjate

Ndikim ne	Alternativa 0			Alternativa 1			Alternativa 2					
	KN	RN	KZ	KNxRN xKZ	RN	KZ	KNxRN xKZ	RN	KZ	KNxRN xKZ		
<b>Popullsi</b>												
- zhurmat	0			0	-1	2	0.5	-1	-1	2	0.5	-1
- Vibrimet	0			0	-1	2	0.5	-1	-1	1	0.5	-0.5
- Pluhura	0			0	-1	3	0.5	-1.5	-1	2	0.5	-1
- clesia e jetes	0			0	1	2	0.5	1	1	2	0.5	1
- ekonomi	-1	2	1	-2	1	3	1	3	1	2	1	2
- turizem, rekreacion	0			0	0			0	0			0
- sport aktivitet	0			0	0	0		0	0			0
<b>Kushtet e trupave ujore</b>												
- rrjedhja e ujrave siperfaqesore	-1	2	1	-2	1	2	1	2	1	2	1	2
- pasqyra e ujrave sipefaqesore	-1	2	1	-2	1	3	1	3	1	3	1	3
- permbyje nga ujrat nentokesore	-1	2	1	-2	1	3	1	3	1	2	1	2
- ujerat nentokesore ne zonat e mbrojtura	-1	2	1	-2	0			0	0			0
<b>Toka</b>												
- zenia e sip. Tokes	0			0	-1	1	1	-1	-1	1	1	-1
- regjimi i ujrave te tokes	-1	2	1	-2	1	2	1	2	1	2	1	2
- erozioni i tokes	-1	2	1	-2	1	3	1	3	1	3	1	3
<b>Fauna &amp; Flora dhe biotopet e tyre</b>												
- gjitaret	1	2	1	2	-1	2	0.5	-1	-1	2	0.5	-1
- shpendet	1	2	1	2	-1	1	0.5	-0.5	-1	1	0.5	-0.5
- peshqit autoktone	1	2	1	2	-1	3	1	-3	-1	1	1	-1
- amfibet	1	1	1	1	-1	3	1	-3	-1	1	1	-1
- flora ne zonen e ndertimit	0			0	-1	3	0.5	-1.5	-1	2	0.5	-1
- flora ne siperafqen perreth	0			0	-1	2	1	-2	-1	1	1	-1
<b>Peisazhi</b>												
- struktura	0			0	-1	1	1	-1	-1	1	1	-1
- perdonimi	0			0	1	2	1	2	1	2	1	2
- terreni	0			0	-1	1	1	-1	-1	1	1	-1
<b>Zonat e mbrojtura dhe nenzonat</b>												0
- Zonat e mbrojtura	0			0	0			0	0			0
- zonat e mbrojtura ujore	0			0	0			0	0			0
<b>Sistemi territorial i stabilitetit ekologjik</b>	0			0	-1	3	1	-3	-1	2	1	-2
<b>Zonat urbane</b>												
- zonat urbane	0			0	0			0	0			0
- perdonimi i tokes	0			0	1	3	1	3	1	3	1	3
<b>Ajri</b>												
- clesia e ajrit	0			0	-1	1	0.5	-0.5	-1	2	0.5	-1
- perqendrimi i emisioneve	0			0	-1	1	0.5	-0.5	-1	2	0.5	-1
<b>Shuma</b>				-7				0.5				5

## 6.2. Impaktet e mundshme negative pa masa mbrojtese

Pritësi i Ndikimit	Burimiiimpaktit	Kohëzgjatja Shtrirja fizike, Madhësia	Kthyeshmëri a ne gjendjen fillestare	Shkalla e ndikimit	Nevojat për masat zbutëse
<b>Toka</b>					
Përdorimi i Tokës	Tjetërsim të përdorimit të tokës në vendet ku do të bëhet ndertimi, si dhe në rrugë kalimet e kamionëve	2	+	--	Përdorimi i Pajisjeve të përshtatshme teknologjike. Lagia e terrenit.
Kontaminimi i tokës	Jo	1	+	-	Plan veprimi
Ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit	Karpenteri Betonim Vibrim	1	--	--	Plan Rehabilitimi Standarte te punimeve
<b>Biodiversiteti</b>					
Vegjetacioni Dëmtim	Sistem i terrenit. Gërmimet. Emetimet e Gazrave dhe pluhrove. Rrjedhjet.	1	--	--	Zbatimi i rregullores. Kushte tekniqe optimale te mjeteve të punës. Parandalim i ndotjes
<b>Fauna</b>					

Shqetësimi specieve,dëmti maksidental i tyre	Sistemi i terrenit. Gërmimet. Emetimet e Gazrave dhe pluhrove. Rrjetet Ndërtimi	1	---	--	Zbatimi i rregullores. Kushte teknike optimale te mjeteve të punës. Parandalimi ndotjes.
<b>Cilësia e ajrit</b>					
Rritje e emetimeve të CO <sub>2</sub> ,CO,N Ox,SO <sub>2</sub> ,LN, HC(VOC),	Rritje të Emetimeve në ajër nga djegia e diesel që përdoret nga kamionët burim por edhe nga automjetet e tjera shoqëruese	1	-	---	Përdorimi i Mbulesave tek kamionët dhe venddepozitimi. Transporti të kryhet në orarete trafikut të lire. Karburanti të jetë cilsor. Kontrolli periodic i mjeteve të punës për shkarkimet. Përdorim i eficënti mjeteve të punës.
<b>Cilësiaeujérave</b>					
Ujërave sipërfaqësore	Aktiviteti i ndertimit, sistemit.	1	--	--	Pastrimin e mjedisit në rast derdhje lëndesh ndotëse në mjedis
Ujërat nëntokësore	Aktiviteti i ndertimit, sistemit.	1	--	--	Pastrimin e mjedisit në rast derdhje lëndesh ndotëse në mjedis
<b>Hidrologjia</b>					
Sistemi i kullim/shkarkimit gjendja hidrologjike, dekantimi, erozioni	Sistemi i terrenit. Gërmimet. Aktiviteti i ndertimit.	1	--	--	Sistemi kanalevekulluese. Muretmbajtëse.
Përbajtjet	JO	JO	JO	JO	Terreni ka pendence & ujrat e larta kullojne në kanalinkryesor drenazhues

Mbetjet						
Shtimi mbetjeve urbane	Shtimi mbetjeve urbane nga aktiviteti humani Punonjësve që do të operojnë në këtë projekt	1	-	-	-	Vënd grumbullimet e diferencuara.
Mbetjet inerte	Sistemi i terrenit. Gërmimet. Aktivitet i indertimit.	1	--	--	--	Venddepozitimbre ndakantierit. Transportne vendepozitimine caktuарнгаNjesia Administrative Ven dore Ripërdorim
Peizazhi						
Ndryshimii peizazhit	Gjat fazes së punimeve & paspërfundimit ku merr peisazhin përfundimtar	2	-	++	++	Duke u bazuar në projektin peisazhi përfundimtar do të rris vlerat e zonës.
Monumentete natyrës dhe të kulturës/Zonat embrojtura	JO	JO	-	++	++	Duke u bazuar në projektin përfundimtar do të kemi rritje të vlerave te zonës.
Zhurmat						
Rritje e nivelit të zhurmave	Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve dhe kamionëve burim	1	--	--	--	Mjete me Kolaudim optimal. Punime gjate orëve të përshtatshme.
Trafiku						
Trafiku	Rritje potenciale e trafikut nga lëvizja e kamionëve dhe mjeteve gjatë implementimit Të projektit	1	-	-	-	Transporti do të kryhet gjate orëve që shmanget pikun e trafikut & në ato zona që shmanget sa me shumë vendet e banuara
Ndikimi Social						

Ndikimi Sociale	Ndikime potenciale negative në komunitet që lidhen me impaktet negative të evidentuara	1	-	--	Do të kërkohet mirkuptimi i gjithë banorëve për zhvillimin optimal të projektit. Banorë të zones do përfshihen në projekt
-----------------	--	---	---	----	---

### 6.3. Analize e Kohezgjatjes se ndikimeve

Aktivitetet që do të japid ndikime të mundshme negativisht në mjedis vetem gjatë të fazes së zbatimit të projektit, ku përfshihet ajo parapregatitore e terrenit dhe të ndertimit të objektit lidhen me veprimtarite si vijon:

- Gërmimet e tokës dhe pastrami i bimesise se terrenit ku do te ndertohen objektet e HEC-it
- Ndertimi i kampit te ndertimit, perfshi magazinat dhe parkimin si dhe zyrave,
- Percaktimi i vendqendrimit te mjeteve;
- Hapja e truallit, ndërtimi i themeleve evadimi i dherave;
- Percaktimi i rrugeve e korridoreve të qarkullimit në sheshin e ndertimit.
- Ndertimi i objektit.

Ndikime të përherëshme mjedisore dhe sociale gjatë funksionimit të objektit ku përfshihen edhe aktivitetet e mirëmbajtjes janë:

- Marrja e përhereshme e tokës për ndertimin e objekteve te veprave te HEC-it;
- Ndryshimi ne pejsazhin rural;
- Rritja e prezences se automjeteve nga hyrjet e daljet ne parkimin nentoke;
- Rritja e numrit të banoreve ne godinen e banimit si dhe prania te punonjesve dhe e frekuentuesve të mjediseve te sherbimit ne katin përdhe.

Impaktet e parashikuara, gjatë punimeve të ndërtimit që mund të zgjasin rreth 18 muaj nuk do të janë të rëndësishme për cilësinë e ajrit në zone.

#### 6.3.1. Kohezgjatje e ndikimeve te mundshme ne Biodiversitet

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë tjëtërsimin e vendit si habitat artificial rural, shqetesimi grupeve të kafshëve eose migrimi i përkohshëm i atyre në zonës në afersishkaktuar nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe makinerive. Po kështu ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afersi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme për të mbështetur biodiversitetin rural. Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit do të jetë i kufizuar dhe rezultojnë në një rëndësie të pothuajse të papërfillëshm, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese.

### 6.3.2. Kohezgjatje e ndikimeve te mundshme ne ujrat siperfaqesore

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me fazen parandërtimore dhe veprimtaritë e ndërtimit të ndryshme (ndërtimi i rrugëve hyrëse eventuale, punime tokësore dhe të kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; strukturat mbajtese, themelet, etj), përfshijnë: Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësoretë cilat janë vlerësuar të jenë të ulët, të njëprobabiliteti të ulët dhe me shtrirje vetëm lokale. Nuk ka asnjë ndikim parashikuar mbetur në ujërat sipërfaqësore e nëntoksore, gjatë fazës së ndertimit.

### 6.3.3. Kohezgjatja e ndikimeve te mundshme ne toke

Ndikimi me kohezgjatje pa limit është tjetersimi i përdorimit të tokes nga punimet e vendosjen se objekteve te HEC. Makineritë e ndertimit si dhe makinëritë e renda që bejnë mbathjen e tokës mund të ndotin zonën me derdhjet e naftës, dhe mund ngjeshin ose të dëmtojë tokën në afersi të objektit.

Ky ndikim pavarësisht nga kohezgjatja, efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar e probabilitet të ulët e me shtrirje lokale duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdorimit të saj.

Nuk ka ndikim të pritshëm në përdorimin e tokës gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes.

### 6.3.4. Kohezgjatja e ndikimeve te mundshme ne ajer

Aktivitetet e ndërtimit do të gjenerojë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Aktivitet që gjenerojne pluhura janë ndertimet e sektorit te punës, rregullime rruvore, pastrime e demolime për formimin e sheshit të ndertimit, ndërtimi i objektit. Shkarkimet ne ajer mund të specifikohen emetime të pluhurave dhe grimcave (pm10). Emetimet me të medha pluhurave mund të ndodhin gjatë oreve të punës në aktivitetet e germimeve e ato ndertimore. Pluhuri nuk shkakton ndryshime të gjata ose të gjera afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në objektet e afërta shkakton ndotje dhe për këtë arsy mund të rezultojë në ankesa por që keto ndikime janë të përkohshme, ose gjatë fazës pregatitore dhe asaj të ndertimit. Ndersa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë dhe që mund të transportohen më gjerë sesa pluhuri, nëpërmjet eres, grimca të lëshuara edhe nga motorët të tillë si kompresorë, gjeneratorë, etj. Si madhësia e emisioneve PM10 është relativisht i vogël, çdo efekte anësore që rezultojnë prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efekte të rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit.

Ndersa gjatë fazës se operimit, ndikimi mund të zbutet duke marrë masat e duhura, të ngjashme me fazën e ndërtimit.

### 6.3.5. Kohezgjatja e ndikimeve te mundshme nga zhurmat dhe vibrimet

Zhurma dhe dridhjet do të gjenerohet kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të janë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si fadromat, vinça, etj. Reagimi i njerëzve për të vibracioneve në terren është e ndikuar nga shumëfaktorë fizike ku perfshihet dhe kohezgjatja. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme. Për shkak të faktit se ka prona banimi në afersi të objektit, ka gjasa që vibrimet nga ndërtimi i objektit të propozuar të jetë të evidentueshme.

#### 6.3.6. Kohezgjatja e ndikimeve të mundshme ne peisazh dhe vizualitet

Ndikimi ne peisazhin rural të zones do te jete i dukshëm. Përceptimi në ndryshim pejsazhi është jo shumë potencial dhe i ambientueshëm me pamjen gjate fazes se ndërtimit. Si përfundim përceptimi veçanërisht në distancë do te jete i moderuar përfaktin se kemi të bejmë me zhvillim të objekteve ne një zone te pazhvilluar..

#### 6.3.7. Kohezgjatja e ndikimeve të mundshme ne peisazh dhe vizualitet

Në fazen ndertimore, burimi kryesor i mbetjeve do të jetë aktiviteti ndërtimor, dhe mbetjet e krijuara nga punëtoret. Duke qënë se shumica e aktiviteteve të ndërtimit rezultojnë me mbetje të kufizuara e jo të rëndesishme, sidomos nga përdorimi i elementeve ndërtimore të parafabrikuar. Fraksionet e mbetjeve që do të krijohen si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit janë në lidhje me llojet e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë kryerjes së fazave të ndërtimit. Mbetjet e ngurta dhe sanitare do të prodhohen nga punëtorët gjatë qëndrimit të tyre në vendet e ndërtimit. Mbetjet e ngurta janë mbeturinat urbane me të njëjtën përbërje e të ngjashme me mbeturinat nga amvisëritë.

Gjatë funksionimit e mirëmbajtjes së objektit, prodhimi i mbetjeve të natyrës urbane është normalisht i administrueshëm pasi do të sherbehet me pikat me kontejnere në lagje përfbanoret si dhe aktivitetet e sherbimeve.

## VII. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

Zbutja e ndikimeve në mjedis gjatë projektimit mund të lidhet me kontolle të ndotjes, por gjithashtu edhe me shtrirjen në zonë, projektin e strukturave te HEC, peizazhin, rregullimet e aksesit, dhe shumë aspekte të tjera të projektit.

Objektivi kryesor i VNM-së është të identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore të projekteve të reja të zhvillimit apo ndryshimeve të aktiviteteve ekzistuese. Brenda këtij qëllimi, procesi i VNM-së kërkon:

- të konsiderohen alternativat për vend-ndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqëruese;
- të përmirësohet plani mjedor i propozimit;
- të sigurohet që burimet janë përdorur si duhet dhe në mënyrë eficiente;
- të identifikohen masat e duhura për zbutjen e ndikimeve të mundshme të propozimit;
- të vendosen kushtet për ndërtimin;
- të ndihmohet vendimarrja dhe informimi i publikut.

Ky kapitull perfshire krahasimin e alternativave dhe aktiviteteve te propozuara dhe zgjedhjen e alternatives me optimale, duke perfshire një krahasim me alternativen Zero, pa nderhyrje.

Hapi i pare i ketij vleresimi te ndikimit ne mjedis te aktiviteteve te propozuara ne mjedis dhe identifikimi i ndikimeve te komponenteve te vecante te mjedisit.

### 7.1. Alternativa 0: Gjendje aktuale e mjedisit, pa ndertim te HEC GOJAN

Sipas alternatives Pa Projekt/Pa Zhvillim te alternatives, presupozon te mos kryhet asgne ndertim dhe asgne nderhyrje dhe te mos zbatohet asgne projekt.

Alternativa pa zhvillim te projektit presupozon qe projekti i propozuar nuk do te miratohet, dhe keshtu nuk do te nndermerret asgne veprim dhe nuk do te kryhet asgne punim.

Qellimi i analizimit te kesaj alternative eshte qe t'i lejoje vendimarresit te krahasoje impaktet e projektit te propozuar perkundrejt alterantives pa zhvillim te projektit

Kjo alternative duket si me e pershtatshmja e pare nga një kendveshtrim ekstrem ambjentalist, per sa kohe kjo alternative siguron mos nderhyrjen ne kushte ekzistuese te zones se perzgjdhur. Megjithate, ne kushtet e alternatives pa projekt, potenciali ujor i lumenit Fan i Madh do te mbetet e pashfrytezuar. Akesesi ne rrugen lidhese do te mbetet i kufizuar dhe gjendja e rruges do te perkeqesohet.


Nga ana tjeter, nevoja per nje zhvillim te tille ne kete zone eshte e larte, dhe ndikimet e paparashikuara mjedisore qe vijne nga ndertimet tashme njihen mire. Megjithate, alternativa pa projekt, eshte me pak e prefereuara po te kthejme vleresimin nga ana social-ekonomike dhe pjeserisht nga perspektiva mjedisore, pasi nese projekti nuk realizohet:

- Perfitimet ekonomike kryesisht gjate fazes se ndertimit, p.sh. punesimi per punonjesit e formuar me nje profesion ose ata pa nje profesion nuk do te realiozohet.
- Nuk do te kete gjenerim te te ardhurave nga zhvilluesi per pushtetin lokal dhe Qeverine
- Statusi social dhe ekonomik i zones do te mbeten i pandyshuar
- Burimet njerezore lokale do te mbeten te paperdorura
- Nuk do te kete mundesi punesimi per banoret e zones ku shtrihet projekt
- Dekurajim i investitoreve

## 7.2. Alternativa 2: Ndertim i HEC GOJAN

### 7.3. Alternativa 3 – Ndertimi i HEC GOJAN me Bypass per peshqit

Peshqit janë pjesë shumë e rëndësishme e mjedisit ujor. Kryesisht për madhësinë dhe shikueshmërinë e tyre ishin të dobishem për të vlerësuar ekosistemin e ujit në të kaluarën e largët. Shumëllojshmëria e tyre tregon shëndet të ambientit. Peshku si tregues biotik lidh shumë përparësi për të vlerësuar me sukses shëndetin e burimeve ujore.



Peshqit mbështeten në migrime për të kënaqur kërkesat e tyre në lidhje me strukturën e biotopo gjatë fazave të ndryshme të jetës. Migrimet mund të jenë ose gjatësore në kanalin kryesor, ose anësore midis kanalit kryesor dhe ujërave anësore. Nevojitet ndërlidhja e ekosistemeve të ndryshme për t'i lejuar organizmit të emigrojnë në mënyrë që të plotësojnë kërkesat e tyre dhe kërkesat e habitateve. Është e rëndësishme ruajtja e lidhjes gjatësore të lumenjve që kanë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për të luajtur në lidhje me shkëmbimin riprodhues, si dhe për përhapjen e popullsisë dhe rikolonizimin e shtresave të shpopulluara të lumit. Një zgjidhje për të rikthyer migracionin e peshqve është krijimi i kalimit per

peshqit dhe kontrolli i rrjedhjes në mënyrë që HEC-et te furnizohen me ujë të mjaftueshëm.

Para se të planifikoni një kalim peshku, hapi i parë duhet të jetë të pyesni nevojën për të ruajtur pengimin ekzistues ndër-lumor, meqë ndërtimi i një kalimi të peshkut është gjithmonë "zgjidhja e dytë më e mirë" për rivendosjen e kalimit të papenguar përmes lumit. Në lumenjtë më të vegjël, sidomos, ka shumë pengesa dhe vepra të tilla si mulli dhe kanale vadirje, të cilët mund të jene braktisur por që ende ndalon migrimin e organizmave ujorë. Heqja e pengesave të tilla duhet t'u jepet përparësi ne krahasim me ndertimin e një kalimi të peshkut, gjatë përpjekjes për rivendosjen e lidhjes gjatësore te lumit. Përjashtimet nga ky parim mund të ndodhin kur konfliktet lindin me kërkesat e tjera ekologjike, siç është ruajtja e ligatinave të vlerësuara nga niveli më i lartë i ujërave të varfër, ose me nevoja sociokulturore rajonale. Kriteret e përgjithshme që duhet të plotësojnë By-pass e peshqeve, përfshijnë kërkesat biologjike dhe sjelljen e organizmave ujorë të migruar, te cilat përbëjnë një aspekt të rëndësishme në planifikimin e by-pass te peshqve. Sidoqoftë, duhet të theksohet se njohuritë e sotme të mekanizmave biologjikë që shkaktojnë ose ndikojnë në migrimin e këtyre organizmave janë akoma të paqarta si duhet dhe ekziston një nevojë e madhe për hulumtime të mëtejshme për të shërbyer si bazë për kriteret për ndertimin e by-passve te peshqve.

Ne keto kushte, nisur nga rendesia qe theksuan me siper, dhe nga krahasimi i alternativave, alternativa 2, me ndertim te HEC-it me By-Pass per peshqit, mund të konsiderohet nga një vlerësim gjithëpërfshirës i ndikimit në mjedis si një variant optimal, me ndikimet më pak negative në mjedis.

Por, nga ana tjeter nisur nga terreni ekzistues ne zone ku do te ndertoohen veprat e marrjes, eshte ende duke u vleresuar me projektuesit ndertimi i tyre si dhe efekti qe do te kene dhe dobishmeria e tyre do te krahasohet me efektet qe mund te kete ndertimi i tyre ne terrenin perkates. Duam te theksojme, qe ne vendet ku do te ndertoohen veprat e marrjes, perrenjte jane te rrembyeshem dhe eshte e pamundur qe peshit te mbijetojne ne keto rryma.

Ne keto lumej, lloji kryesor i peshkut qe takohet eshte Trofta e memertë (*Salmo marmoratus*), e cila eshte edhe ne librin e kuqe te Faunes Shqiptare.

Sidoqofte, një zgjidhje tjeter eshte qe vepra qe do te siguroje lenien ne shtratin e lumit prurjen ekologjike te sherbeje edhe si by-pass per peshqit.

#### 7.4. Shtrirja e ndikimeve te mundshme

Gjatë aktivitetit të punimeve do të ketë lëvizje të automjeteve, punime gërmimi të konsiderueshme dhe si pasojë zhvendosje të inerteve ose prishje të vegjetacionit pyjor, hapje tunelesh, kanalesh derivacioni, punime ndërtimi muresh, beton arme, mbushje me zhavorr, etj.

Gjatë punimeve të zbatimit të projektit do të kryhen punime betoni për veprat e marrjes, për shuarjen e energjise në dalje, për tunelet e derivacionit, dekantuesit, sifoni, për ankera dhe bloqe mbështetës të tubacioneve të rënies së turbinave, për basenin e presionit, për ankera bloqe mbështetës dhe mure anësore (për derivacionin me tub celiku pa presion) dhe mur rrithues i sallave me beton për mbrojtje nga përmbytjet. Studimi parashikon realizimin e këtyre veprave me objektet dhe nënobjektet e tyre me një afat kohor brenda 23 muajsh. Normalisht punimet do të fillojnë me ato përgatitore si ngritja e kantiereve, sigurimi i rrugëve për në sheshin e ndërtimit

nderve e celo	27.10	07.11	09.11	07.11	09.11	07.11	09.11	07.12	09.12	11.12	13.12	15.12	17.12	19.12	21.12	23.12	25.12	27.12	29.12	31.12	01.01	03.01	05.01		
nderve pjk	212.22	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12	12.12		
11. BLOQI DHE ZAKA ZE BENE	5																								
12. ZIFOLUJE	1																								
13. DERIVACIONI VEPREVE E LEZOGOCOKE	2																								
14. DERIVACIONI DHE PREDIT ZIE RERAKU	3																								
15. BLOQI BENEVOLLA TUBELLAZHE	1																								
16. ZONE DHE KERKES CILINDRIVE	6																								
17. DERIVACIONI LUMBOVKE	2																								
18. BLOQI DHE MBRIOZ	3																								
19. LIGJET I KERKESAVE	10																								
20. DERIVACIONI	3																								
21. KERKETI GZHOBËS	3																								
22. JELBYJE VJOSHEZ	1																								
23. BLOQIZZUE	3																								
24. DERIVACIONI BLOKUJE	3	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	
25. DERIVACIONI BLOKUJE	3	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	
26. DERIVACIONI	5	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	10.11	
27. EMELETI	2001	1	3	9	4	2	8	1	8	9	10	11	15	17	14	12	16	11	18	13	50	31	33	37	

С В У Е И К О И Б Р З И Д Е А Е

## VIII. MASAT E PROPOZUARA PER ZBUTJEN E NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MBROJTJEN E TIJ, MASAT REHABILITUESE

### 8.1. Vleresim i per gjithshme i masave zbutese

Ky seksion përfshin përshkrimin e Planit të Menaxhimit Mjedisor (PMM) të projektit. Qëllimi kryesor i PMM është të sigurojë një proces të drejtë gjatë projektimit, ndërtimit dhe operimit në terma të impaktit dhe masave parandaluese të vleresuara më lart. PMM dhe Programi i Monitorimit Mjedisor do të jetë në formën e një drafti në mënyrë që të sigurojë implementimin e rekomandimeve parandaluese dhe të parandalojë ndonjë ndikim të mundshme mjedisor të anashkaluar në raportin e VNM-së. Pavarësisht nga kjo, PMM stimulon procedurat dhe rregullat që duhet të ndiqen gjatë ndërtimit dhe për me shumë gjatë operimit të këtij biznesi. Plani i menaxhimit vlerësohet në këto fazë kryesore.

**Fazën e projektimit:** Gjatë kësaj fazë është e rendësishme identifikimi i pronarëve, për të shmangur konfliktin midis mjedisit natyror dhe menaxhimit të tokës, ku kjo fazë tashmë është e përfunduar pasi toka është në pronësi të vet subjektit që investon si dhe ka përfunduar hartimi i projektit për ndërtimin e strukture objekt i ketij studimi dhe vleresimi mjedisor.

**Fazën e ndërtimit:** Punimet e ndërtimit për këtë objekt do të zbatohen nën mbikëqyrjen e supervizorit të përcaktuar nga kontraktori. Plani i punës dhe i punimeve do të ndërmerret nga kontraktori para se të fillojnë në terren punimet specifike, bazuar në kapacitetin e kontraktorit (numri i punonjësve, numri dhe cilësia e mjeteve dhe makinerive që disponojnë për këtë proces). Punimet e ndërtimit duhet të sistemohen dhe programohen në mënyrë të tille që të minimizojnë ndikimin në mjedis.

Gjelberimi gjithashtu eshte një aspekt shume i rendësishem. Ne rastin konkret sheshi do te rrrethohet me gjelberim ne cdo hapesire qe do jete e lire dhe pa funksion. Ai do te perbehet nga: gjelberim i larte me peme dekorative dhe gjelberim i ulet ne nivelin e shkurreve dhe barit. Perveç intimitetit qe krijon ai ndikon drejtperdrejt ne cilesine e ajrit. Gjelberimi ul nivelin e zhurmës ne objekt, rrit nivelin e ajrit te paster duke ndihmuar ne nje gjendje me te mire psikologjike te punetoreve dhe ne nje lidhje me te ngushte me natyren.

#### Hierarkia e masave zbutese parashikon:

- Shmangien ne burim
- Minimizimin duke e zgjogluar ne vend
- Minimizimin duke e zgjogluar tek receptorë
- Riparimi i demit
- Kompensimi ne natyre
- Kompensime te tjera dhe nxitje

#### Fazën e dekomisionimit:

## **IX. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**

### **9.1. Vleresim i per gjithshme i masave zbutese**

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikoje në dhënien e zgjidhjeve për shmangje të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

- Për këtë arësy që në fazën e projektit do të merren masat e mëposhtme:
- Të gjitha fazat e nënprojekteve do të janë të zgjedhur me kujdes për të shmangur ose minimizuar ndikimin potencial në mjedis dhe në komunitetet përreth.
- Punimet e ndertimit do të janë të vendosura, dizajnuara dhe të orientuara për të minimizuar zhvendosjet e mundshme të dherave dhe devijimin e burimeve ujore të mundshme.
- Ndkimi i shtresave te rezervuarve (depove) do të jetë e projektuar për të shmangur nëmaksimum zonat e ndjeshme mjedisore.
- Planimetria e sheshit do të janë të dizajnuara në mënyrë burimet e zhurmës do të jetë sa më larg nga zonat e afërtë të banimit qe të jetë e mundur.

### **9.2. Masat mbrojtese**

Nga këndvështrimi i kërkesave mjedisore për ndërtim, ndikimi negativ në mjedis eshte minimizuar qe në fazën përgatitore të projektit duke analizuar dhe vlerësuar ndikimin e ndërtimit në mjedis, duke shmangur kështu një rritje të shpenzimeve për shkak të ndikimeve të paparashikuara gjatë fazës së ndërtimit.

Njohja e mjeteve për të vlerësuar ndërveprimin midis njerëzve, burimeve natyrore dhe projekteve të ujit eshte zhvilluar, shpërndare dhe përdorur me qëllim zbutjen e ndikimeve negative dhe përmirësimin e mjedisit.

Në funksion të rezultateve të vlerësimeve të ndikimit, për zbutjen e ndikimeve të mundshme në mjedisin do të ndërmerren masat e mëposhtme gjatë fazës së ndertimit te kapanonit. Masa mbrojtese dhe parandaluese qe rekomandohen gjate fases se ndertimit

### **9.2. Masat konkrete për mbrojtjen e cilësisë së ajrit**

Me qëllim qe shkarkimet në ajër që emeton veprimitaria ndërtuese të janë vazhdimisht brenda normave të lejuara, subjektet ndërtues, marrin këto masa:

- a. Shmangia sa më shumë që është e mundur e kalimit te kamionëve të transportit të rëndë në të zonën e banuar;
- b. Mbulimi i kamioneve të transportit dhe stoqeve të matërialeve për të evitar ndikimin e përhapjes së pluhurave nga era;
- c. Spërkatje e stoqeve dhe rrugët e hyrjes me ujë, gjatë sezonit të thatë për të minimizuar pluhurin;

- d. Sigurimi i pajisjeve personale mbrojtëse për punëtorët për të minimizuar rrezikun nga pluhuri dhe të tjera substancave ndotëse;
- e. Të sigurohet që të gjitha automjetet e ndërtimit të janë nënshtruar mirëmbajtjes së rregullt dhe të përshtatshme në kushtet teknike, në përputhje me specifikimet e sipas prodhuesve e standardeve;
- f. Përdorimi lëndëve djegëse, të cilat janë në përputhje me standartet zyrtare (sipas Urdhëresa nr 6, nga 09.10.2007, përbajtja e sulfurit në naftë, duke filluar nga 01.01.2011 duhet të jetë 10mg max/kg);
- g. Monitorimi i cilësisë së ajrit në bazë të VKM Nr.435, të 12.09.2002, "Për normat e shkarkimeve në ajër, në territorin e Shqipërisë", VKM Nr 803, dhjetor 2003, "Për normat e cilësisë së ajrit" dhe VKM Nr 103, i 31.3.2002, "Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë". Udhëzimi nr.6527 datë 24.12.2004 "Mbi vlerat e lejueshme të elementeve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra te kontrollit të tyre" përcakton kufijtë e lejueshëm të elementeve ndotës të ajrit në mjedis, që shkarkohen me gazet, nga përdorimi dhe trafiku i automjeteve rrugore, si dhe I kufirit të zhurmave të ndotjes akustike shkaktuar për të njëjtën arsy;
- h. të përdoren mbulesa të përkohëshme dhe të lagen sipas nevojës, një deri dy herë në ditë për të reduktuar çlirimet e pluhurave;
- i. për lëvizjen e materialeve në kantier e në sheshe ndërtimi, të përdoren konvejerë të myllur;
- j. të mirëmbahet sheshi i ndërtimit gjatë kryerjes së aktiviteteve të nivelimit, ndërtimit dhe transportit;
- k. të gjitha ngarkesat të sigurohen nëpërmjet rregullimit, lagies ose mjete të tjera për të parandaluar derdhjet, rrjedhjet dhe pluhurat;
- l. të gjitha materialet e transportuara jashtë sheshit të ndërtimit të janë të lagura në mënyrë të mjaftueshme ose të mbuluara mirë;
- m. të gjitha aktivitetet e pastrimit, nivelimit, ndërtimit dhe transportit të ndërpriten gjatë periudhave me erë të fortë
- n. të kufizohet shpejtësia e lëvizjes së kamionëve në kalimet e sheshit të ndërtimit, deri në 30 k/orë;
- o. të ndalohet përgatitja dhe përpunimi i bitumeve në temperaturat të larta në kantieret e ndërtimit dhe të përdoren bitume që kanë shkallë të vogël çlirimesh të ndotësve në ajër;
- p. të vendosen mbulesa mbrojtëse për mbeturinat e ekspozuara ndaj erës;
- q. gjatë kryerjes së proceseve të rifiniturës (suvatim, lyerje, veshje fasade), objekti të jetë i mbuluar me rrjeta mbrojtëse.

### 9.3. Masat konkrete për administrimin e mbetjeve te ngurta

Gjate aktivitetit per realizimin e projektit do te kete lindje mbeturinash te ngurta por jo te demshme. Guret qe do te dalin nga germimet per hapjen e tuneleve te derivacionit, trasete e derivacionit me tubacion ne pjesen shkembore do te riciklohen per ndertimin e mureve, te baseneve te presionit, godines së HEC-it, rruget, etj.

Shtresa e tokes qe do te hiqet gjate instalimit te strukturave perkatese dhe veprave perberese do te depozitohet ne nje vend depozitimi te perkozhshem ku kjo shtrese do te ruhet per tu riperdorur (por do te konservohet sipas kerkesave perkatese pasi ruajta e shtresave afatgjate sjell shperpezim te saj) ne procesin e sistemimit te zones pas perfundimit te gjithe proceseve te kerkuara ndertimore. Kjo shtrese do te vendoset konform kushteve qe do te percaktohen nga supervizori i punimeve per te shmangur prishje te imazhit te zones perreth. Si dhe do te behet nje ngjeshje e mire e saj per te shmangur fundosje te ketyre shtresave te tokes dhe per te parandaluar efektin e erozionit te shtresave te reja qe do te krijohen gjate rehabilitimit te zones.

Subjektet ndërtues të godinave, rrugëve, urave, shesheve, trotuareve, administrojnë mbetjet që gjenerohen nga veprimtaria ndërtuese, duke marre këto masa:

- a. mbetjet që gjenerohen nga veprimtaria ndërtimore, të sistemohen të ndara e të veçuara sipas llojit të tyre, në vende të paracaktuara që më parë për qëndrimin e tyre provizor;
- b. mbetjet të largohen çdo ditë nga sheshi i ndërtimit dhe te dërgohen në vendgrumbullimet e përcaktuara nga pushteti vendor;
- c. transportimi i tyre të bëhet në oret me trafik të pakësuar;
- d. për transportin e materialeve dhe të mbetjeve të përdoren makina të mbulura dhe që nuk rrjedhin;
- e. mbetjet toksike të dërgohen në një vend depozitim të miratuar posaçërisht për to;
- f. të pastrohen menjëherë rrjedhjet, derdhjet, pikimet për të parandaluar ndotjen e tokës;
- g. të shtrohen me zhavorr dhe të mirembahen rrugët brenda sheshit të ndërtimit;
- h. shërbimet dhe riparimet e makinerive e të pajisjeve të bëhen sipas grafikut dhe në vende të përcaktuara për këtë qëllim;
- i. të lahen gomat e automjeteve para daljes nga sheshi i ndërtimit.

### 9.4. Masat konkrete për mbrojtjen nga zhurmat

Në çdo kantjer ose shesh ndërtimi, subjektet ndërtues, hartojnë dhe zbatojnë programin e masave për mbrojtjen nga zhurmat, i cili synon:

- a. të respektohen standartet për nivelin e zhurmave;
- b. aktivitetet e prishjes dhe të ndërtimit, të kufizohen në orët që sjellin shqetësimë për banorët perreth;

- c. aktivitetet e prishjes dhe ndërtimit të programohen sipas një grafiku në mënyrë që të evitohet operimi i disa pajisjeve e makinerive në të njëjtën kohë i cili shkakton nivele të larta zhurmash;
- d. makinerite e pajisjet e fuqishme të ndërtimit, si dhe ato që gjenerojne zhurma mbi kufijtë e lejuar, të jenë të pajisura me ekrane mbrojtës për zhurmat.

## 9.5. Prurja ekologjike

Referuar kushteve hidrologjike shume të mira që na rezervon pellgu ujëmbledhës në akset e veprave të marrjes së HEC-eve është pranuar prurja ekologjike në kufnjë minimalë për vetë faktin se poshtë këtyre akseve ka kontributë të konsiderueshëm të ujrale nga të dy krahët e luginës, të cilët rrisin vlerën e prurjes ekologjike të këtyre degëve në afërsi të kufijve maksimalë bazuar rekandimeve dhe Ligji Nr.111/2012 date 15.12.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" nen 39, pika 4 për përdorimin e burimeve ujore i cili shprehet që: "Pavarësisht nga sasia e rrjedhjes ekologjike që përcaktohet në planet e menaxhimit të baseneve, ajo nuk mund të jetë më e vogël se prurja me qëndrueshmëri 355 ditë në vit (Q355)".

Pra parashikimi i rrjedhës ekologjike **Q355 ditore** e prurjeve për muajin me të thatë, ruan njëkohësisht trashëgiminë e florës dhe faunës ekzistuese ujore eshte parashikuar te jete  $0.53 \text{ m}^3/\text{s}$ , si dhe nevojave të tjera të komunitetit si ujite eshte parashikuar një prurje per  $0.15 \text{ m}^3/\text{s}$ .

## 9.6. Masat te tjera mbrojtese

- Per përdorimin e tokes: Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave të dhëna në relacion. Respektimi i kushteve teknike dhe standardeve.
- Per vegetacionin: Punime me mbrojtje brenda kantjerit, lagie e tokes. Te mos preken territoret kufitare gjate kryerjes se punimeve te ndertimit;

Pamvaresisht sa pershkrurhet me lart ne masat zburese, investitori angazhohet që te kompensoje humbjes e habitatit do te vije si pasoje e ndertimit te veprave te HEC GOJAN. Rehabilitimi dhe kompensimi do te behet ne bashkepunim te ngushte me pushtetin vendosr. Ndertimi i HEC GOJAN, do te behet ne perputhje me Planin e Zhvillimit te Zones dhe do te ruaj te paprekur teresine e paisazhit rural te zones, dhe që zbatimi i projektit të do të jetë i tillë që nivelet e ndotjes të jenë nën nivelet e specifikuara.

### 9.6.1. Mbjellja e fidaneve te rinje.

Duke qene se si pasoje e shfrytezimit do te krijohen gropë, kanale, projekti parashikon qe te mbillen peme ne keto siperfaqe te lira. Per kete subjekti parashikon te shpenzoje nga fitimet e saj. Procesi per sistemimin e tarracave dhe mbjedhjen e pemeve do te filloje mbas fillimit te shfrytezimit. Perkujdesja e fames

per zhvillimin e bimesise do te vazhdoje edhe mbas mbjelljes. Ne perventivin perfundimtar te projektit eshte parashikuar nje shume prej 1.000.000 leke te reja.

#### 9.6.2. Sistemimi i sterileve

Sistemimi i mbetjeve teknologjike sic theksohet me siper do te behet ne sheshin qe do te krijohet ne fazen e ndertimit dhe me pas kur te filloje sistemimi i skarpateve do te merret e do te depozitohet ne ane te shtratit te vepres per te realizuar kijimin e shtresave vegjetale e mbjedhjen e pemeve per mbrojtjen nga erozioni i metejshem.

#### 9.6.3. Mirembajtja e siperfaqeve te mbjella

Ajo do te realizohet nga subjekti. Mund te ngrihen prita per te perforuar mbrojtjen e pyjeve nga erozioni ne zonat rreth veprave te HEC-it.

#### 9.6.4. Gjelberimi i mjediseve rreth godines se HEC-it

Krijimi dhe rikrijimi apo dendesimi i mbuleses se gjelbert apo gjelberimi i rrethinave te objekteve eshte ne funksion te rehabilitimit mjedisor te territorit, ku keto objekte qe ngrihen e ndryshojne mjedisin, ulin cilesine e tij prane ketyre objekteve. Ne funksion te rehabilitimit, peisazhit te ketij territori do te perfshihen ne Planin e Rehabilitimit:

Rigjelberimi i habitati prane godines se hidrocentralit me bimesi autoktone dhe joautoktone, krijimi i nje sipeifaqe te gjelbert qe te jete e sinkronizuar me ndertimin e godines dhe te mjedisit rrethues, gjithashtu krijimi i nje tapeti te gjelbert afer godines se kombinuar me drure dekorative te nje lartesie te vogel dhe gjithmone te gjelbert.

Keto punime synojne rehabilitimin e peisazhit, amortizimin e zhurmave, rritjen e qendrueshrnerise mjedisore, etj.

Rigjelberimi i habitatit me bimesi autoktone, prane vend-depozitimeve te inerteve, prane vepres se marrjes, basenit tepresionit, tubacionit te presionit.

Pjese e Planit te Rehabilitimit Mjedisor do te jete mbjellja e drureve pyjore rreth ketyre objekteve me nje rezistence karshi thatesires e nglices per te mbrojtur nga erozioni dhe rritjen e jetegjatesise se ketyre veprave.

#### 9.6.5. Rigjelberimi i vatrave te eroduara.

Territori ku do te ndertohej HEC-i dhe veprat inxhinierike, aktualisht paraqitet me shfaqje te erozionit me nje shkalle te larte intesiteti. Per te frenuar aktivitetin e erozionit dhe ne funksion te rehabilitimit mjedisor te territorit, i cili rezulton i perkeqesuar per shkaqe te trasheguara si prishjen epyjeve duke i hapur toka te reja, ku eshte ne vazhdim shplarja e tokes aktive e dalja e shkembijnje ne siperfaqe, por dhe me nderhyrjet me punimet e parashikuara ne projektin e ndertimti te HEC-it do te perfshihen ne Planin e Rehabilitimit keto punime:

Mbjellja e fidaneve pyjore ne vatrat e eroduara dhe ne vatrat ku mbulesa bimore eshte e degraduar dhe me drure te rralle ne sasite qe do tepercaktohen ne baze te siperfaqes.

#### 9.6.6. Pyllezime e Mirembajtja habitateve

Siperfaqja e fondit pyor qe zene te gjithe elementet e ndertimit te hidrocentralit do te zevendesohet me mbjellje drure pyjore ne ngastrat eshte projektuar hidrocentrali me anekset e tij

Ne gjithe masat rehabilituese, perfshihen dhe mirembajtja e habitatit. Konkretizimi ne terren i ketyre masave parashev uljen mbi rritjen dhe zhvillimin e gjallesave (flora dhe fauna) qe nenkupton ndalimin e vjeljes se prodhimeve te dyta pyjore dhe kufizimin ne maksimum te prerjeve te ketyre siperfaqeve pyjore ku do te ndertohet HEC-i, ndalimi ne menyre kategorike i prerjeve te pyjeve ekzistuese.

Kjo do te arrihet duke marre masa paraprake si gjate shfrytezimit ashtu edhe gjate ndertimit duke bashkepunuar me organet pyjore si dhe pushtetin lokal si dhe vendosjen e shenjave paralajmeruese dhe postoblloqe per moshyrjen e mjeteve dhe personave qe shkaktojne demtime ne mjedis, si dhe do te planifikohet nje roje per mbrojtjen e pyjeve, ku kalon kanali i derivacionit gjate ndertimit te HEC-it. Duke qene se terreni ka pjerresi te madhe dhe dheu eshte i shkrifet ne pjesen e poshteme te kanalit te tubacionit te turbinave, fidaneve do t'u kryhen sherbime per tre vitet epara, duke krijuar gjate punimit vendin e fidanit ne forme tarrace per mbajtjen e lageshtires.

#### 9.6.7. Sistemimet malore

Sistemimet malore do te synojne pengimin e fenomentit te eozionit te tokes ne shpatet e pjerret. Kryesisht punimet do te natyres se pritave te vogla dhe prjentimit te prroskave, gardhe, mure mbajtes, gjerdhe, etje. Volumi nuk mund te vleresohet ne kete faze te projektit, por ne zbatimin e keti projekti, do te bejme gjithcka mundemi qe mjedisit, dhe pyjeve ku shkel gjurma e ketij projekti t'ju ruajme vlerat dhe t'jua shtojme ato

Do te kryhen sistemime malore ne:

- Prane Vepers se Marries
- Pergjate kanalit ku do te vendoset tubacioni i turbines/shpateve te pjerrtat



94

#### 9.6.8. Sistemime inxhinierike

- Germimi i shpateve dhe masat inxhinierike per stabilizimin e tyre

Per ndertimin e vepres se marrjes, dekantuesit, baseni te presionit dhe tubacionit te turbinave, do te kryhen germime ne terren kryesisht shkembore.

Germimet ne trase jane projektuar me nderhyrje ne shpatet natyrale te tokes, duke marre ne konsiderate faktin qe reliefet ne per gjithesi, jane me tendence afer gjendjes kufitare te qendrueshmerise duke ditur qe formacionet qe jane ne kete zone jane flishore (Argjiloro-Ranoro).

Ndikimi i germimit ne aks te trasese se tubacionit eshte vleresuar ne baze te dy parimeve kryesore gjeomorfologjike dhe gjeologjik, si me poshte:

- Reduktimi ne germimet e reja ndikon ne gjendjen e qendrueshmerise se shpatit;
- Ndikimi i germimeve te reja ne ruajtjen e kushteve te shkembinjeve nen mbulesen e tyre eluviale - deluviale.

Per te siguruara gjendjen e qendrueshmerise se shpatit nga germimet, ne per gjithesi duhen bere veprime te shpejta, sepse kane ndikim negative faktoret klimaterik, perajrimi i shkembinjeve dhe dobesimi i dherave, ne germimet e reja ne per gjithesi kur ato behen me veprime te ngadalshme.

Si rrjedhoje, germimet e reja do te behen ne baze te vleresimit te rezervave ne gjendjen e

qendrueshmerise se shpatit, nderkohe qe masat inxhinierike jane menduar kryesisht per shmangien e faktoreve ekzodinamik dhe ato te perajerimit.

- Germimet e skarpatare dhe masat Inxhinierike per aksin e tubacionit

Vemendje i eshte kushtuar germimeve te medha qe perbejne aksin e tubacionit. Ne perputhje me rezultatete e studimit eshte rekanduar si me poshte:

1. Germimi i skarpateve duhet bere me makineri duke evitar lendet eksplozive. Kjo eshte e mundur vetem per shkembinje qe germohen me makineri. Perdonimi i eksplozivit shkaterron strukturen dhe do te krijon veshtiresi per stabilizimin e skarpateve.
2. Te gjitha germimet duhet te behen sipas kushteve gjeoteknikje dhe gjeologjike. Per formacionet e dobeta rekandohen skarpatat 1V:1 H, dhe per shkembinje kompakt 3V:2H.
3. Skarpatet e germimit duhet te jene deri 5-6 m lartesi, me gjeresi berme 1.5 m.
4. Germimet rekandohen te shoqerohen me drenazhime ne kurore, qe largojne ujrat siperfaqesore.

Gjate germimit te trases se kanalit, per te siguar stabilitetin e germimeve, duhet te merren parasysh mjaft fenomene fizike-gjeologjike-gjeodinamike ne zhvillim si dhe te vleresojet qendrueshmeria e germimeve ne pershtatje me kushtet me te disfavorishme. Mbështetur sa me siper rekandohet qe gjate germimit te ruhet gjendja e ekuilibrit, te behet largimi i dherave te papershtatshme, te behen matje te nivitet te ujtit, bazamentet te fiksohen ne shkemb te fresket dhe skarpatet te pylezohen ne akcie te shkurtra dhe peme me rrenje te thella.

## X. NDIKIME TE MUNDSHME NE MJEDISIN KUFITAR

Projekti per ndertimin e HEC GOJAN, nuk zhvillohet ne zone nderkufitare dhe nuk ka natyre te tille.